



Nr.1(70). JANAR 2025

PROFILI



DR. AJET XHafa
"MJEKU I VITIT 2024"

KIRURUGU UROLOG DUARARTË
NGA BULQIZA, NË SPITALIN
AMERIKAN TË PRISHTINËS

Faqe 3

URIMI



**FESTIME
MJESHTRI:**
**FALEMINDERIT
BULQIZA IME!**

Faqe 2

NDESHJA



**FERIT KETA
SHKRUAN
HISTORINË, MBRON
TIËTULLIN BOTËROR
NË KIKBOKS**

DR.ADRIATIK BALLA

Faqe 12

FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT KONKURUESE DINJITOZE ME SIPËRMARRJET NË RANG VENDI

BUKUROSH KOÇI: INVESTIME QË GARANTOJNË PERSPEKTIVËN

KONFERENCA KOMBËTARE

Kauza e dibranëve do të fitojë

Është me shumë rëndësi bashkimi i dibranëve për ti thënë ndal një investimi që na i përmbyt vlerat e Dibrës tonë. Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" është shprehur publikisht për të qenë të bashkuar, në kraht të njëri tjetrit, për çdo rast që dëmtohen interesat e dibranëve dhe të Atdheut. Unë sjell këtu për të gjithë ju zërin e kryesisë së "Shoqatës Bulqiza" që jemi kundër ndërtimit të hidrocentralit Skavica dhe jemi për ta mbrojtur Dibrën nga përmbytja e të gjenden forma të tjera të investimeve dobiprurëse.

NGA BASHKIM LAMI

FAQE 7



Edhe për vitin 2025, ne mendojmë se duhet të mbajmë këto nivele prodhimi, ku në total, me të tre fabrikat, duhet të prodhojmë 25,000 ton koncentrat kromi me cilësi 38-52% Cr2O3

Faqe 3

DOSSIER

Faqe 9

80 - VJETORI I SHKOLLËS 8 - VJEÇARE TË VIÇISHTIT TË DIBRËS



NGA EMIN CAMI

EKSPERTËT

Faqe 11

KONFERENCË SHKENCORE PËR HIDROGJENIN NATYROR NË MINIERËN E BULQIZËS

PROF. ASOC. DR. BARDHYL MUCEKU

TAKIMI

Faqe 14

FUQIA E FJALËS SË SHKRUAR NË RUAJTJEN E IDENTITETIT KULTUROR



HALIL RAMA - MJESHTËR I MADH

HOMAZH

Faqe 15

LAMTUMIRË MIKU E SHOKU YNË MENDU OSMAN DEMA!

NGA BASHKIM LAMI

SUPLEMENTI LETRAT

• FAJI ËSHTË I URDHËRUESIT TË LUFTRAVE

TREGIM NGA SAKIP CAMI

Faqe 13

• Ramazan Kica dhe kolana e tij për historinë e Skënderbeut dhe të Dibrës

SALI ONUZI

Faqe 10

NDERIMI

Faqe 8

HALIL RAMA DHE SKËNDER MURRJA "QYTETAR NDERI" TË BULQIZËS



Këshilli Bashkiak vlerëson gazetarin e shkrimtarin e mirënjohur dhe mësuesin veteran shembullor

KRYEBASHKIAKJA MJESHTRI: FALEMINDERIT BULQIZA IME!



• *“Pedonalja plot, më e bukur se asnjëherë, fëmijët u kënaqën, dhe ky ishte shpërblimi më i madh për punën dhe përkushtimin e një ekipi të tërë, që i dha qytetit tonë shkëlqimin që meriton...”*



Ndërsa ka ndezuar dritat e pemës madhështore të Vitit të Ri 2025, më 7 dhjetor 2024 në qendër të qytetit minator, në praninë e mijëra qytetarëve, kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri i ka uruar ata përzemërsisht: GËZUAR 2025 - FALEMINDERIT BULQIZA IME.

Një ditë më parë (6 dhjetor 2024) u organizua një takim festiv që i dha qytetit dritë shkëlqimtare.

“Pedonalja plot, më e bukur se asnjëherë, fëmijët u kënaqën, dhe ky ishte shpërblimi më i madh për punën dhe përkushtimin e një ekipi të tërë, që i dha qytetit tonë shkëlqimin që meriton. Sot çelëm siparin e festave, me një urim të përzemërt për shëndet, mbarësi dhe gëzim në çdo familje bulqizake. Një falënderim i veçantë për këngëtarën Vera Laci dhe për të gjithë ata që iu bashkuan këtij momenti simbolik, festiv”, tha ndër të tjera kryebashkiakja Mjeshtri në çelje të këtij takimi.

Kanë të drejtë të festojnë e gëzojnë. U mbyll një vit i suksesshëm, u realizuan dhjetra investime që shënuan transformimin e dëshuëruar, jo vetëm në qytetin të Bulqizës edhe të dhjetra fshatrave.

Një ditë më pas, 8 Dhjetori – Dita e Rinisë Kombëtare, sërish takim festiv i organizuar nga Bashkia. Qytetria e parë e kësaj bashkie Festime Mjeshtri si dhe qindra të rinj e të reja komunikojnë duke parë njëri-tjetrin në sy. Kjo është mënyra më e mirë për t'i thënë gjërat ashtu siç i ndiejmë, pa frikën e të qenit të gjykuar. “Ky ishte dhe qëllimi i këtij takimi me të rinjtë plot energji dhe entuziazëm të Bulqizës, me të cilët folëm për punët që janë bërë gjatë këtij viti dhe për angazhimin maksimal që kemi treguar për t'i përfshirë ata në proceset e vendimmarrjes. Të rinjtë kanë qenë pjesë aktive në konsultime për çështje si

buxheti, mjedisi dhe arsimit, si dhe janë përfshirë në aktivitete sportive, kulturore e letrare, si në nivel lokal, ashtu edhe kombëtar. I ftova të rinjtë të shfrytëzojnë maksimalisht bibliotekën e pasuruar të qytetit, një hapësirë ideale për mësim, detyra ekstrakurrikulare dhe për të zgjeruar horizontet e tyre. Ata, nga ana tjetër, shprehën dëshirën për më shumë aktivitete sportive, që të krijojnë gara të shëndetshme mes shkollave të njëjësive përreth”, shprehet entuziaste Znj. Mjeshtri.

Si Bashkia, vijnë të mbështesim rininë në çdo hap, sepse besojnë fort se ata janë garancia e një të ardhmeje më të mirë për Bulqizën dhe për vendin.

RRITJA E PERFORMANCËS DHE BESUESHMËRISË SË ADMINISTRATËS

Në të vërtetë, kthesa e shënuar gjatë këtij viti dëshmon para së gjithash rritjen e performancës dhe besueshmërisë së administratës të Bashkisë.

Ballafaqimi me premtimet e para një viti nxjerr në pah jo vetëm përmirësimin e tyre, por edhe tregues të tjerë që kanë të bëjnë me parametra bashkëkohorë të një bashkie në rritje e zhvillim intensiv. Nëse deri para një viti, shumë nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare e shihnin me skepticizëm bashkëpunimin me Bashkinë e Bulqizës, kjo vinte nga prapambetja e trashëguar, sidomos në infrastrukturën e vetë bashkisë. Që të fitohej besimi reciprok, duhej nisur pothuajse nga e para.

Sfida kryesore mbeteshin burimet njerëzore. Kryetarja e Bashkisë, Festime Mjeshtri, pikërisht këtë sfidë po e përballon me dinjitet, duke ndërtuar një administratë të aftë profesionalisht dhe të përkushtuar, për ta bërë Bashkinë e Bulqizës (dhe jo vetëm qytetin minator) të standardeve të përparuar. Kryerja e analizave me përgjegjësi, identifikimi në kohë i problematikave dhe përcaktimi i rrugëzgjdhjeve efikase sollën që në vitin e parë të mandatit të saj ndryshimin e kërkuar. Kështu gjatë vitit të fundit, Bashkia Bulqizë ka ndërmarrë një sërë projektesh të rëndësishme në fusha të ndryshme, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët.

Është investuar në infrastrukturë, mjedis, shërbime sociale, arsim dhe sektorë të tjerë kyç. “Sigurisht, kemi ende shumë për të bërë dhe projekte

të tjera janë planifikuar për t'u implementuar në të ardhmen. Shumë nga këto projekte do të zhvillohen pas konsultimeve me komunitetin për të vlerësuar prioritetet”, – shprehet kryebashkiakja Mjeshtri.

Parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, arritjet janë evidente në infrastrukturë, në rrjetin e kanalizimeve dhe ndriçimin, në përmirësimin e mjedisit, shërbime sociale e arsim. Evidente janë edhe projektet me donatorët e huaj. Kjo, falë drejtimit me kompetencë e përkushtim nga Festime Mjeshtri që nga 23 maji 2023 kur mori drejtimin e bashkisë e deri sot. Arritjet e deritanishme janë bazë për një program edhe më ambicioz për vitin 2025.

BULQIZË, ASFALTOHET RRUGA HYRËSE DHE DALËSE E RRUGËS SË ARBRIT

Kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Znj. Festime Mjeshtri bën të ditur për opinionin publik se është sistemuar dhe asfaltuar rruga hyrëse dhe dalëse e Rrugës së Arbrit, me një gjatësi prej 2.2 km. “Kjo ndërhyrje ka një rëndësi të veçantë për sigurinë e qytetarëve, pasi hyrja dhe dalja në Rrugën e Arbrit ka qenë një problematikë e vazhdueshme për banorët e Gjoricës, duke u shndërruar shpesh në burim aksidentesh”, bën të ditur për “Gazeta Bulqiza” kryebashkiakja Mjeshtri.

Gjithashtu, ajo pohon se pjesë e këtij projekti ka qenë edhe faza e dytë e rehabilitimit të rrugës Cane-Qendër. Në këtë segment janë ndërtuar kanale dhe mure betoni të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e rrugës. Këto ndërhyrje infrastrukturore janë thelbësore për të mbrojtur rrugën nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga kushtet atmosferike dhe për të garantuar një funksionalitet të plotë të saj për një periudhë të gjatë kohore.

Investime të tilla janë një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të infrastrukturës lokale dhe tregues i angazhimit tonë për të përmirësuar nevojat e komunitetit.

FUSHË BULQIZË/REHABILITOHET DHE SISTEMOHET PËRROI I THATË

Para disa ditësh Kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Znj. Festime Mjeshtri ishte në terren për të parë nga afër punimet e përfunduara për rehabilitimin dhe sistemimin e Përroit të Thatë në Njësinë Administrative Fushë Bulqizë. Ajo bën të ditur se ky projekt,

i realizuar nga Bashkia Bulqizë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ka përfshirë sistemimin e rrjedhës së lumit dhe ndërtimin e 350 ml mure mbrojtëse, të përforcuara me rrjeta gabioni teli, për të mbrojtur parcelat bujqësore dhe ndërtesat nga përmbytjet dhe dalja e lumit nga shtrati.

SHUPENZË-INAUGUROHET “MUZEU I DIJES”

Merr jetë inisiativa rinore në Shupenzë, inaugurohet biblioteka e të rinjve “Muzeu i dijes”. Të rinjtë në Shupenzë të Bashkisë së Bulqizës tashmë kanë një hapësirë të dedikuar për veprimtari krijuese, për të mësuar dhe për të ndërvepruar me njëri-tjetrin.

Grupi rinor arriti të finalizonte inisiativën e identifikuar përgjatë rrugëtimit me metodologjinë “Ti Krijon” duke sjellë një ndryshim të rëndësishëm për bashkëmoshatarët dhe komunitetin e tyre.

Kjo inisiativa e të rinjve u mundësua në kuadër të programit « Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria” të udhëhequr nga UNICEF Albania dhe të mbështetur financiarisht nga British Embassy Tirana

MEKANIZMI LOKAL I KOORDINIMIT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE

Mekanizmi lokal i koordinimit në Bashkinë Bulqizë koordinon përpjekjet e përbashkëta të aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile për të parandaluar trafikimin, nxitur bashkëpunimin dhe për të ndërhyrë kur ka nevojë duke garantuar referimin efektiv të rasteve.

Në takimin reflektues dhe koordinues të rrjetit aktorët e Bashkia Bulqizë Faqja Zyrtare dhe Qendres Komunitare Multifunkionale reflektuan mbi rezultatet e arritura dhe diskutuan sfidat e hasura gjatë vitit 2024.

Nën moton “Bashkimi bën fuqinë” u theksua rëndësia e qasjes së vazhdueshme të mekanizmit lokal duke ofruar mundësi për përmirësimin e cilësisë së punës të përbashkët.

Ky takim u zhvillua në kuadër të programit “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria”, zbatuar nga Terre des hommes, udhëhequr nga UNICEF Albania dhe mbështetur nga British Embassy Tirana.



Festime Mjeshtri

Është sistemuar dhe asfaltuar rruga hyrëse dhe dalëse e Rrugës së Arbrit, me një gjatësi prej 2.2 km. Kjo ndërhyrje ka n...



BUKUROSH KOÇI: INVESTIME QË GARANTOJNË PERSPEKTIVËN

Edhe për vitin 2025, ne mendojmë se duhet të mbajmë këto nivele prodhimi, ku në total, me të tre fabrikat, duhet të prodhojmë 25,000 ton koncentrat kromi me cilësi 38-52% Cr2O3

Etuziast për bilancin mjaft pozitiv me të cilin mbylli vitin 2024, Administratori i Fabrikës së Kromit Bulqizë, Ing. Bukurosh Koçi flet për investime që garantojnë perspektivën e kësaj sipërmarrjeje, konkurrese dinjitoze në rang vendi. Në intervistën ekskluzive për "Gazeta Bulqiza", ai rendit rezultatet mjaftë pozitive të arritura gjatë vitit 2024, ndërsa për vitin 2025, shprehet i sigurtë për të mbajtur këto nivele prodhimi, ku në total, me të tre fabrikat, parashikon të të prodhojnë 25,000 ton koncentrat kromi me cilësi 38-52% Cr2O3.

Z. Koçi, Fabrika e Pasurimit të Kromit që Ju administroni është ndër sipërmarrjet më të sukseshme në rang vendi. Më konkretisht, a keni një bilanc të arritjeve për vitin 2024?

-Së pari, ju urojmë Gëzuar Vitin e Ri 2025 të gjithë punonjësve të shoqërisë Fabrika e pasurimit të Kromit në Bulqizë, Kalimash, Gjakovë, si dhe minierave në Tërnovë, Qafë Lamë, Kalimash. Po ashtu, u urojmë Gëzuar Vitin e Ri 2025 të gjithë banorëve të Bashkisë Bulqizë. Sa i përket pyetjes suaj, shoqëria jonë ka arritur rezultate pozitive edhe gjatë vitit 2024, të cilat i renditim më poshtë:

- Është punuar dhe realizuar detyra në prodhimin dhe eksportin e koncentratit të kromit, duke arritur të eksportojmë 100% të prodhimit të vitit 2024.
- Prodhimi i koncentratit është rritur me 12.5% në krahasim me vitin 2023.
- Objektivi i dytë ka qenë realizimi i investimeve në fabrika me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit teknologjik, rritjen e shkallës së rikuperimit dhe përmirësimin e cilësisë së koncentratit.
- Një investim tjetër ka qenë përfundimi i instalimit dhe vënia në punë e paneleve diellore me fuqi të instaluar prej 1 MW, të cilat, nga muaji mars deri në 1 dhjetor 2024, kanë prodhuar rreth 1 MW.
- Jemi angazhuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe të sigurisë në punë për punonjësit në fabrika dhe miniera.
- Investime të tjera janë bërë në blerjen e makinerive dhe mjeteve të rënda, si sondë, ekskavator, fadro-ma, kamionë etj., duke rinovuar parkun tonë të makinerive të rënda dhe transportit.
- Investime të rëndësishme janë bërë në kryerjen e punimeve minerare në minierat "Livadhi i Dashit", "Tërnovë", "Qafë Lamë Klos", dhe "Kalimash" në Kukës, ku janë hapur më shumë se 800 metra



- galeri, si dhe 3 kariera, me qëllim prodhimin e mineralit të kromit si lëndë e parë për fabrikat e pasurimit.
- Eksporti i koncentratit ka arritur nivele të kënaqshme, pavarësisht rënies së kursit të dollarit, dhe gjithashtu të ardhurat janë rritur me mbi 30% krahasuar me vitin 2023.
- Kjo si rezultat i rritjes së cmimit të eksportit në gjashtë mujin e dytë të vitit.
- Po ashtu, është punuar intensivisht për kërkim-zbulimin e mineralit të kromit, me qëllim rritjen e rezervave për shfrytëzim, duke përfshirë mineralin e varfër që do të përpunohet në fabrikat e pasurimit, si dhe për eksport.
- Një rëndësi të veçantë i është dhënë edhe kualifikimit të punonjësve të rinj, dhe aktualisht kemi mbi 100 punonjës, ku 25-30% e tyre janë punonjës të rinj.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2024, kemi realizuar një rritje të pagave në mënyrë të diferencuar, në përputhje me profesionin, eksperiencën, arsimin dhe detyrat që secili punonjës kryen.
- Është punuar gjithashtu për kontrollin dhe monitorimin e mjedisit në fabrikë, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme dhe përmirësimin e standarteve mjedisore.

Ju e keni shtrirë aktivitetin edhe në Kalimash e Gjakovë. Ç'mund të thoni për performacën e tyre?

-Që nga viti 2011, zhvillojmë aktivitetin në Gjakovë, Kosovë. Edhe atje, puna ka vazhduar rregullisht gjatë vitit 2024, me ritme normale, duke prodhuar kon-

centrat kromi.

Në Gjakovë, është punuar për të mbajtur gatishmërinë teknike, përmirësuar kushtet e punës, si dhe për sigurimin e lëndës së parë. Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë rritur pagat me mbi 30% krahasuar me vitin 2023. Po ashtu, është punuar për monitorimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të mjedisit, si dhe të shkarkimeve të ujit, duke realizuar të gjithë parametrat e kërkuar.

Sa i përket fabrikës së ndërtuar në Kalimash, Kukës, në vitin 2017, puna ka vazhduar normalisht. Gjatë vitit 2024, kjo fabrikë ka shënuar një rritje të përpunimit dhe të prodhimit prej mbi 40% krahasuar me vitin 2023. Po ashtu, është rritur prodhimi i mineralit të varfër nga minierat që ne administrojmë. Siç jeni të informuar, kjo fabrikë është një ndër fabrikat më moderne të automatizuara, ku përdoren teknologjitë më të avancuara të pasurimit.

Kujdes i veçantë është treguar për kualifikimin e punonjësve, pasi shumica e tyre, rreth 90%, janë të rinj, me moshë 20-25 vjeç. Ne mendojmë se kemi formuar një staf të mirë punonjësish, të cilët janë të aftë për të punuar në fabrikë. Po ashtu, edhe në minierat që ne administrojmë, janë organizuar grupe pune të afta për të kryer të gjitha detyrat.

Cilat janë sfidat me të cilat jeni përballur?

-Ky lloj biznesi është një biznes i vështirë, pasi jo çdo kush mund ta realizojë. Sfidat janë të shumta dhe fillojnë që nga sigurimi i lëndës së parë, të cilën ne pjesërisht e prodhojmë vetë dhe pjesërisht e blejmë nga palët e treta.

Një tjetër sfidë është sigurimi i fuq-

isë punëtore të nevojshme për fabrikat dhe minierat, si dhe kualifikimi i tyre.

Luhatjet e mëdha të çmimit të mineralit të kromit dhe të koncentratit në bursë paraqesin gjithashtu një sfidë të madhe.

Po ashtu, një tjetër sfidë është gjetja e tregjeve të qëndrueshme dhe të garantuara, të paktën për një vit.

Përveç kësaj, duhet të plotësojmë kërkesat e tregut lidhur me llojin e koncentratit të kromit. Ne eksportojmë koncentrat kromi për nevojat e metalurgjisë, por edhe për industrinë kimike.

Deri tani, kemi arritur të sigurojmë kontrata eksporti njëvjeçare për në Kinë, Francë dhe Bullgari.

Nisur nga eksperiencia e 24 viteve, sfidat kanë qenë të mëdha, por deri tani i kemi përballuar me sukses.

Çfarë objektivash konkrete synoni për vitin 2025?

-Edhe për vitin 2025, ne mendojmë se duhet të mbajmë këto nivele prodhimi, ku në total, me të tre fabrikat, duhet të prodhojmë 25,000 ton koncentrat kromi me cilësi 38-52% Cr2O3.

Për të arritur këtë, duhet të prodhojmë dhe blejmë në total rreth 300,000 ton mineral të varfër si lëndë e parë, me cilësi mbi 10% Cr2O3.

Me uljen e cilësisë së prodhimit të mineralit të kromit, duhet të përshtasim teknologjitë e pasurimit për të arritur pasurimin e mineralit me përmbajtje deri në 5-6% Cr2O3, duke siguruar që fabrika të mbetet rentabel. Kjo do të bazohet në eksperiencën e fituar në fabrikën e pasurimit në Kalimash ku po punohet duke pasuruar mineral kromi me përmbajtje 5-6%Cr2O3.

Kjo është detyra më e vështirë, pasi do të duhet të ndryshojmë përsëri teknologjinë, duke futur procesin e parapasarimit me suspenca dhe triflo, ose pasurimin manjetik. Kjo teknologji, megjithatë, nuk është gjithmonë e suksesshme, pasi varet nga shumë faktorë, si natyra dhe përmbajtja e mineralit.

Në fabrikën e pasurimit të kromit në Bulqizë, do të përfundojë montimi i plotë i linjës së parapasarimit. Po ashtu, do të realizohet montimi i impiantit të riqarkullimit të ujit brenda fabrikës, me la mela.

Do të montohet linja e furnizimit me lëndë të parë duke montuar ushqyes me pllaka dhe baraban dezintegruar të mineralit në hyrje.

Gjithashtu, do të instalohen panele diellore me fuqi 0.5 MW brenda territorit të fabrikës.

Në përfundim, do të kryhet rikonstruksioni i laboratorit dhe zyrave të fabrikës.

Dr. AJET XHAFA, KIRURUGU UROLOG
DUARARTË NGA BULQIZA, NË SPITALIN
AMERIKAN TË PRISHTINËS

MJEKU I VITIT 2024

HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

Gjatë shkollimit dhe specializimit ka operuar bashkë me urologë shumë të njohur në Turqi dhe në botë. Dr. Ajeti ka një mori publikimesh në kongrese dhe revista të njohura ndërkombëtare. Gjatë gjithë punës së tij në Shqipëri dhe Kosovë, Dr. Ajet Xhafa ka spikatur për marrëdhëniet shumë të mira me pacientët dhe për performancë tejet të lartë. Ndërhyrjet e realizuara prej tij, në veçanti ndërhyrjet e reja si operacionet e mbyllura (pa prerje klasike) të gurëve në veshka (Nefrolitotomi Perkutane) kanë pasur një shkallë shumë të lartë suksesi në të gjithë rajonin e Ballkanit.

Dy vjet më parë (22-25 tetor 2022), ekipit të shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza, që me mbështetje dhe sipërmarrësit të suksesshëm Bukurosh Koçi, bëri një vizitë në Prizren, Krujë e Madhe e Gjakovë të Kosovës, iu bashkua edhe DR. AJET XHAFA - Kirurg Urolog, në Spitalin Amerikan të Prishtinës (Spitali Amerikan - American Hospital Kosova). Në mbyllje të kësaj vizite, kryesia e kësaj shoqate e nderoi Dr. Ajetin me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza" me motivacionin: "Intelektual e veprimtar i shquar bulqizak, që ka arritur rezultate shumë të larta në formimin e tij profesional e shkencor në fushën e mjeksisë për mbrojtjen ne jetës së njerëzve dhe qytetar model që mban lart dashurinë e tij për vendlindjen".

Dy vjet më pas, pikërisht, mbrëmjen e 20 dhjetorit, gjatë një ceremonie festive në prag të festave të fundvitit, Drejtoria e Spitalit Amerikan të Prishtinës e shpalli Dr. Ajet Xhafen "MJEKU I VITIT 2024".

Për këtë vlerësim ai falenderon nga zemra drejtuesit e spitalit, mjekët, infermieret dhe të gjithë personelin e spitalit Amerikan në Prishtinë, që falë bashkëpunimit kanë arritur që të diagnostifikojnë dhe të shërojnë me mijëra pacientë prej vitesh. "Ky çmim nuk është vetëm një vlerësim për punën dhe përkushtimin tim, por është një motivim i madh për të vazhduar të shërbej me zemër dhe përkushtim ndaj pacientëve dhe komunitetit. Ky çmim shkon për te gjithë personelin spitalor që çdo ditë punojnë me pasion dhe përkushtim për të përmirësuar jetën e të tjerëve. Le të vazhdojmë së bashku në rrugën e kujdesit dhe humanizmit", shprrhet i entuziazmuar Dr. Ajet Xhafa.

Për këtë vlerësim ai ka marë dhjetra urime nga kolegët e miqtë e veçanërisht nga bashkëpatriotët e tij në Bulqizë e Dibër, që e vlerësojnë si mishërues dhe përcues të vlerave më të mira njerëzore, intelektuale dhe profesionale....

PAK NGA CV-JA E DR. AJETIT

Dr. Ajet Xhafa nga Bulqiza, ka shkuar që ne vitin 1996 në Izmir të Turqisë dhe ka mbaruar liceun ushtarak "Maltepe Askeri dhe ne vitin 2000 ka vazhduar Fakultetin e Mjekësisë Gülhane "Guhane Askeri Tip Akademisi" në Ankara të Turqisë. Më pas ka vazhduar specializimin dhe ka marrë titullin "Specialist i Urologjisë" në vitin 2011 po në këtë spital.

Spitali ushtarak "Gulhane Askeri Tip Akademisi" ku është shkolluar Dr. Ajet Xhafa mbahet si një nga qendrat me numrin më të madh të operacioneve në Turqi dhe për menaxhimin e rasteve me teknologjinë më të fundit. Kjo i ka mundësuar që gjatë shkollimit dhe specializimit të operojë bashkë me urologë shumë të njohur në Turqi dhe në botë. Në saje të ndihmës së pandalur të profesorëve, ka arritur që



të avancohet në nivele të larta në fushën e Endourologjisë, Uro-Onkologjisë, Andrologjisë, Kirurgjisë Urologjike Pediatrike etj.

Pas përfundimit me sukses të specializimit në vitin 2011, me gjithë mundësinë e vazhdimin të profesionit në Turqi, vendosi që të kthehet dhe të ushtrojë profesionin në Shqipëri.

Gjatë gjithë punës së tij në Shqipëri dhe Kosovë, Dr. Ajet Xhafa ka spikatur për marrëdhëniet shumë të mira me pacientët dhe për performancë tejet të lartë. Ndërhyrjet e realizuara prej tij, në veçanti ndërhyrjet e reja si operacionet e mbyllura (pa prerje klasike) të gurëve në veshka (Nefrolitotomi Perkutane) kanë pasur një shkallë shumë të lartë suksesi në të gjithë rajonin e Ballkanit. Këto arritje janë prezantuar edhe në Kongresin e Endourologjisë Botërore në Cape - Toën të Afrikës së Jugut ne vitin 2016.

Prezantimet e tij kanë qenë pjesë e serisë së rasteve të para të këtyre ndërhyrjeve të kryera në Tiranë dhe në Prishtinë. Dr. Ajet Xhafa ka kryer një numër të madh operacionesh tek të rriturit, si: zmadhimin e prostatës, ngushtimin e kanalit të urinës (uretra) dhe operacione të mbyllura e të hapura për gurët në kanalën urinar (ureter) dhe në veshkë. Ka trajtuar rastet e para të vendosjes së nefrostomisë në Kosovë dhe rastet e para të operacioneve nga mjekë shqiptarë me laparoskop për kistet e veshkës, gurët në ureter dhe heqjen e veshkës. Ka kryer shumë operacione të mbyllura për kancerin e vezikës, të veshkës dhe të prostatës. Pjesë e punës së tij, veçanërisht në Prishtinë, Kosovë, kanë qenë edhe ndërhyrjet e realizuara tek fëmijët me probleme të lindura si: hipospadias, testise të pa lëshuara, vezikoureteral Reflux (VUR), Ureterocele etj.

Dr. Ajet Xhafa është përfaqësues i rajonit në shoqatën e Urologëve të Evropës (EAU) për grupin e Urolitiazës (gurëve në rrugët urinare) dhe është pjesë e grupit të punës për vlerësimin metabolik dhe kërkimeve shkencore për sëmundjen e gurëve në veshka, (shih linkun: <http://uroeb.org/section/eulis/eorking-groups/>). Është anëtar i shumë shoqatave kombëtare dhe ndërkombëtare të urologjisë: shoqatës së Urologëve Evropianë (EAU) prej vitit 2007, shoqatës së Endourologjisë Botërore, shoqatës së Urologëve të Turqisë prej vitit 2006, shoqatës së Endourologjisë Turke dhe i shoqatës së Urologjisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Ai gjithashtu ka

qenë pjesë e stafit organizues të disa kurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për urologjinë. Përgatitja, angazhimi dhe puna e tij e vazhdueshme janë tregues të pasionit të tij për profesionin dhe suksesit të tij në rritje.

Dr. Ajet Xhafa është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Zotëron gjuhët e huaja), Anglisht (niveli i avancuar), Turqisht (niveli i avancuar), Italisht (niveli i avancuar) dhe Frëngjisht (niveli mesatar).

PJESËMARRËS DHE REFERUES NË KONGRESE DHE REVISTA TË NJOHURA NDËRKOMBËTARE

Dr. Ajet Xhafa ka një mori publikimesh në kongrese dhe revista të njohura ndërkombëtare. Para disa ditësh (28 tetor - 1 nëntor 2024) Dr. Ajet Xhafa ishte i ftuar si panelist në Kongresin e 33. kombëtar të Urologjisë Turke. Më me 31 Tetor ai foli në këtë Kongres të rëndësishëm për udhëzimet e reja në trajtimin e gurëve në sistemin urinar. "Në kongresin e 33-të të urologjisë Turke pata fatin të marr pjesë në 3 kirurgji live dhe bashkë me dy akademikë të nderuar moderuam sesionin për gurë në veshka. Përveç organizimit të mirë dhe temave interesante pata mundësinë të takoj shumë miq nga studimet në

urinar si prostata, veshkat, fshikeza, problemeve seksuale ose inferilitetit, problemeve urologjike te femijeve ose çështjeve të tjera urologjike.

Për faktin se problemet urologjike janë të shpeshta tek të gjitha moshat, dr. Ajeti shprehet se se ka shumë rëndësi kujdesi i vazhdueshëm dhe vizitat tek urologu.

Ai ka kryer dhjetra operacione të ndërlikuara duke përdorur aparatura moderne Laser Auriga XL 50 ëatt për trajtimin e gurëve në veshka

Këto ndërhyrje nuk kryhen më për herë të parë, por çdo ditë nga ekipi i urologjisë në Spitalin Amerikan në Kosovë.

KRENAR QË LINDI DHE U RRIET NË NJË VEND TË VOGËL SI BULQIZA

Më 5-8 prill 2024 dr. Ajet Xhafa ishte drejtues dhe penalist në Kongresin më të madh të urologjisë që u zhvillua në Paris. Në këtë Kongres rreth 15 000 urologë nga e gjithë bota prezantuan me qindra punime shkencore. Profesorë me emër treguan për përvojat e tyre kirurgjikale të viteve të fundit. "Vetëm në panelin që drejtuam së bashku me dy kolegë të tjerë, kishte 18 punime nga Cape Toën, Vancouver, Singapor, Oklahoma dhe qytete të



Spitali Amerikan Kosovë - Prishtinë

Turqi dhe për këtë dua të falenderoj Shoqatën e Urologjisë Turke për ftesën dhe besimin e dhënë. Shpresojmë të shihemi së shpejti në kongrese të tjera për përditësim të njohurive në shërbim të pacientëve", -shkruan Dr. Ajeti në faqen e tij në facebook.

Më parë, (11 maj 2024) përfundoi kongresi i 14-të i urologëve të Kosovës. Dr. Ajeti e vlerëson atë një kongres të organizuar mirë me tema interesante, diskutime, debate me kolegë shqiptarë dhe të huaj, disa prej tyre miq nga studimet në Turqi. Vetë Dr. Ajet Xhafa prezantoi eksperiencën 12-vjecare në Kosovë me operacionet për gurë në veshka siç është PNL si dhe ndërhyrjet me laparoskop të lazer që kryejnë prej vitesh në Spitalin amerikan në Prishtinë. Deri në kongresin e ardhshëm ai shpreson që të vazhdojë ta përmisojmë veten në të mirë të pacientëve. Dhe jo vetëm kaq. Me vizionin e tij bashkëkohor ai herë pas here ju vjen në ndihmë pacientëve me video live ku ka treguar thjesht dhe bukur me gjun profesionale, sesi zgjidhen problemet e gurëve në veshka, prostatës etj. me metodat më të reja të teknologjisë, e njëjtë me çdo cep të globit. Në këto dalje live ai u ka mundësuar pacieëntëve të shumta nga Kosova e Shqipëria të mësojnë më nga afër rreth problemeve te traktit

ndryshme europiane", ka pohuar dr. Ajeti për rrjetet sociale. Dhe ndonëse merr pjesë dhe drejton e referon në evnete të tilla të ndërkombëtare të një rëndësie ët veçantë, ai nuk nguron të shpreh krenarinë për vendlindjen e tij. Është vërtetë frymëzues pohimi i tij publik se "... në këtë ditë të veçantë shpresoj që babai im të ndihet krenar, që edhe pse më rriti në një vend të vogël si Bulqiza, kjo nuk më pengoi të bëhem pjesë e barabartë e tryezës më të madhe urologjike në botë".

Krenarinë për bashkqytetarin e tij nga Bulqiza e shpreh edhe kampioni i botës në kikboks Ismail Keta. Para dy viteve (29 maj 2022), në ditën e fundit të vizitës së tij me disa miq gjermanë në Kosovë, ai shprehej se si "qershia mbi tortë, takoi kushëririn e tij, Dr. Ajet Xhafa i cili jeton prej vitesh në Prishtinë. "E kam quajtur 'fatkeqësi' që Dr. Ajeti u largua nga Bulqiza, pasi vendlindja ka nevojë për specialistë të tillë dhe pse mirekuptoja arsyen siç është kantandisja e spitalit të Bulqizës 30 vitet e fundit. Por gëzohem që ju shërbën vëllezërve dhe motrave shqiptare në Kosovë. Faleminderit për mikpritjen që organizove për miqtë e mi gjermanë Ajet", shkruan kampioni Keta .

Nga Kanadaja e Anglia vijnë për trajtim dhe ndërhyje në klinikën e urologjisë të Spitalin Amerikan Prishtinë

-Përshëndetje Dr. Xhafa. Tashmë që jeni bërë një nga më të njohurit kirurgë urologë shqiptarë, donim të dinim nëse ishte zgjedhja juaj Spitali Amerikan i Prishtinës?

-Unë kam studiuar në një qendër shumë të avancuar ushtarake ku çdo teknologji e re që dilte në Europë, sillej fillimisht në spitalin tonë në Gulhane Askeri Tip Akademisi (GATA) në Ankara, dhe kam pasur fatin që të punoj me urologë shumë të shquar në Turqi. Kjo është edhe arsyeja që pasi u ktheva nga specializimi po kërkoja një vend ku të kryeja vetë operacionet e reja që kisha mësuar kohët e fundit gjatë specializimit, ndaj kur mu ofrua pozicioni primar në spitalin e sapohapur në Prishtinë doja të sfidoja dhe të tregoja vehten pas gjithë asaj experience të gjatë prej 15 vjetësh. Përveç kësaj doja të njihja nga afër shqiptarët e ngelur jashtë kufirit të Shqipërisë të rritur në një shoqëri më të hapur se ajo komuniste si e jona. Për këtë arsye fillova të punoj tre ditë në javë në Prishtinë dhe tre ditë të tjera në Tiranë. Por pas një kohe udhëtimet me makinë u bënë të lodhshme dhe duhej që të vendosesh në një vend bashkë me familje, ndaj zgjedhja të punoj në Prishtinë. Pas një kohe të shkurtër në Prishtinë gjeta një popull që megjithëse sapo kishte dalur nga një luftë e egër, kishin ditur të ruanin mirësjelljen dhe respektin ndaj njeri tjetrit dhe sidomos ndaj mjekëve dhe personelit shëndetësor. Më pritën shumë mirë dhe më pas arrita të krijoj besim te populli i Kosovës. Kam vazhduar punën dhe operimet prej vitesh dhe jam shumë i kënaqur me zgjedhjen që kam bërë.

• Sa herë jam pyetur nga njerëz të ndryshëm, ose kam dhënë intervista të ndryshme, gjithmonë kam shprehur krenarinë që jam nga Bulqiza, një zonë me njerëz shumë punëtorë, që kanë kontribuar shumë në të ardhurat vjetore të Shqipërisë, që nga koha e komunizmit. Kam dëshirë që të kontribuoj në ndihmë të pacientëve të rajonit të Dibrës dhe besoj se në të ardhmen, me hapjen edhe të tunelit të Murrizit të Rrugës së Arbërit mund të vij për vizita pa pagesë në rast se kërkohet nga institucionet shtetërore për pacientët që kanë probleme urologjike. Kjo është edhe një nga porositë e lëna nga babai im Pëllumb Xhafa, mua dhe familjarëve të mij para se të ndërronte jetë. Çdokush që ka hedhur themelet e njeriut që është sot duhet të kontribuojë për vendlindjen dhe për njerëzit e asaj zone

MERR MENDIM UROLOGJIK

Prej rreth 12 vitesh kemi kryer ndërhyrje me metodat më bashkëkohore në urologji. Kontaktoni me Dr. Ajet Xhafa për të marr mendim urologjik.



Dr. Ajet Xhafa
Kirurg Urolog

- Trajtimi i gurëve në veshka
- Trajtimi i sëmundjeve të prostatës
- Trajtimi i kancerëve në rrugët urinare
- Trajtimi i infertilitetit te meshkujt
- Trajtime urologjike te fëmijët

REZERVO TERMININ
+383 48 60 40 20

Urologjia | [urologjia.com](https://www.urologjia.com) | [ajetxhafa.com](https://www.ajetxhafa.com)

-Sa operacione të ndërlikuara keni realizuar në vitin 2024?

Çdo muaj kryej rreth 300-350 vizita, dhe rreth 35-40 operacione të ndryshme. Nga këto raste rreth 25% e tyre janë me të vërtetë raste sfiduese për shkak se pacientët në rajon vohnen dhe vijnë kur problemi është zmadhuar më shumë se ç'duhet. Kjo është edhe arsyeja që jemi bërë një qendër shumë e mirë për urologji, sepse kemi

trajtuar raste të veshtira dhe të rënda në bashkëpunim me ekipin e anesteziës dhe reanimacionit si dhe kolegëve të tjerë. Zakonisht trajtojmë raste të veshtira me gurë në veshka, zmadhim të prostatës, probleme me infertilitetin, kancere në rrugët urinare si dhe probleme urologjike te fëmijët. Kemi raste nga gjithë rajoni e nga diaspora, si dhe operacione të personelit ushtarak të huaj në Kosovë. Këto raste më

herët transferoheshin me helikopter në qendra ushtarake në Gjermani. Kohët e fundit asnjë rast nuk është dërguar për trajtim urologjik jashtë Kosovës për ndërhyrje. Kemi shumë shqiptarë që jetojnë në Gjermani, Zvicër, Finlandë etj, që vijnë për trajtim në urologji për shkak të kohës shumë të gjatë të pritjes në këto vende. Gjithashu kemi patur pacientë edhe nga Kanadaja, Anglia, etj, që kanë ardhur për trajtim dhe ndërhyrje në klinikën e urologjisë në Spitalin Amerikan. Jemi një nga qendrat që kemi kryer operacionet e para për gurë në veshka me shpim (Nefrolitotomi perkutane), operacione me lazer për gurë në veshka, operacione me laparoskop dhe shumë ndërhyrje të tjera. Më herët pacientët largoheshin për ndërhyrje të vogla në qendrat e Shkupit, Beogradit, Stambollit, por sot neve na vijnë pacientë nga vendet e tjera. Javën e kaluar operova një pacient suedez të ardhur për ndërhyrje, i cili u kthye brenda tre ditësh në Suedi.

-Si e gjykoni nivelin e shërbimit shëndetësor në spitalet shqiptare dhe çfarë duhet ndrequr?

Unë nuk mund të jap ndonjë mendim profesional për spitalet publike në Shqipëri sepse nuk kam patur punë me menaxhim spitalor. Kam punuar vetëm si kirurg me pacientë me probleme urologjike, por nga eksperiencia ime dhe e ko-

legëve në Turqi jemi në gjendje të japim këshilla të vleshme se si menaxhohej puna atje dhe si ishte hierarkia brenda spitalit. Wshtë një grup shumë i madh mjekësh të diplomuar jashtë që punojnë në institucione publike dhe private që mund t'u kërkohet që të japin mendimet e tyre për përmirësimin e kushteve dhe të gjendjes nëpër spitale. Por për shkak se spitalet në Shqipëri drejtohen nga njerëz që janë aktivë në parti politike dhe nuk kanë shkolimin e duhur për menaxhim spitalor, atëherë kjo çon në prishjen e ekuilibrit mjek-infermier-pacient dhe krijohen vazhdimisht probleme në funksionimin e spitalit dhe dhënie më të mirë të shërbimit mjekësor.

-Sa i lidhur jeni me vendlindjen tuaj Bulqizën?

Unë, sa herë jam pyetur nga njerëz të ndryshëm, ose kam dhënë intervista të ndryshme, gjithmonë kam shprehur krenarinë që jam nga Bulqiza, një zonë me njerëz shumë punëtorë, që kanë kontribuar shumë në të ardhurat vjetore të Shqipërisë, që nga koha e komunizmit. Kam dëshirë që të kontribuoj në ndihmë të pacientëve të rajonit të Dibrës dhe besoj se në të ardhmen, me hapjen edhe të tunelit të Murrizit të Rrugës së Arbërit, mund të vij për vizita pa pagesë në rast se kërkohet nga institucionet shtetërore për pacientët që kanë probleme urologjike. Kjo është edhe një nga porositë e lëna nga babai im Pëllumb Xhafa, mua dhe familjarëve të mij para se të ndërronte jetë. Çdokush që ka hedhur themelet e njeriut që është sot duhet të kontribuojë për vendlindjen dhe për njerëzit e asaj zone.

Dibra gjithmonë ka nxjerrë njerëz të shquar që kanë kontribuar shumë në mbarëvajtjen e vendit tonë dhe do vazhdojmë të jemi të tillë edhe për shumë vite. Me anë të prestigjiozes fjalaelire.com dua të përshëndes të gjithë njerëzit e zonës së Dibrës dhe veçanërisht minatorët e Bulqizës, të cilët rrezikojnë çdo ditë jetën në punën e vështirë që kryejnë. Një këshillë miqësore për të gjithë dibranët është që të mbajnë dhe të përkrahin njerëzit si dhe të ndihen mirë dhe të krenohen me sukseset e njerëzve që kanë origjinën nga ai vend i vogël, i ftohte por shumë i dashur.

Me përlujtje për të gjithë zonën: Kirurg Urolog Ajet Xhafa.

INTERVISTOI: HALIL RAMA

MJEKU I VITIT 2024

(Vijon nga faqja 4)

KËNAQËSI E VEÇANTË KUR MERR VLERËSIMIN E PACIENTËVE

Padyshim që dr. Ajeti ndjen kënaqësi të veçantë kur merr vlerësime ngë pacientët e shumtë. Janë të shumë pacientët që pasi janë operuar nga dr. Ajeti e falenderojnë atë për zëmërisht Dhe nuk janë një e dy, por qindra e qindra nga e gjithë Kosova e Shqipëria që e falenderojnë atë për zëmërisht për përkushtimin me të cilin u ka shërbyer duke i rijtjer në jetë, Në kabinetin e tij të punës na bën përshtypje një foto ku ai është me Halilin dhe Izerin, dy vëllezërit që i ka operuar për zmadhim të prostatës në vitin 2019 dhe 2022. Të dy, megjithëse s'kane më probleme vazhdojnë kontrollat periodike çdo vit me analiza dhe çdo gjë në shëndetin e tyre duket shumë mirë.

"Çdo pacient që ka problem urologjik mund të sjellë edhe vëllain, sepse shërojmë edhe probleme të tilla vëllazërore", na thotë dr. Ajeti.

Edhe Rrustem Elezi thotë se ndihet mirënjohës me dr. Ajet Xhafa në Spitali Amerikan - American Hospital Kosova. Pasi është kryer me sukses operacioni në veshkë i motres së tij Liries, në Spitalin Amerikan ai fillimisht falenderon Zotin për gjithçka dhe të gjithë ata që kanë kontribuar që ky operacion të realizohej. Gjithsesi ai veçon në falenderimin e rij doktorin duarratë, kirurugun urolog Ajet Xhafa për këtë mirësi që i bëri motrës së tij.

E Falenderoj Dr. Ajet Xhafa. "Zoti ju shpërblefte dhe ju begatofte Ju dhe familjen tuaj Dr. Ajeti", shprehhet ai entuziast dhe me gëzim të paparë.

Ai pohon se këto ditë kanë patur raste shumë sfiduese në urologji dhe fatmirësisht janë zgjidhur të gjitha me metodat më të reja, falë aparaturave dhe mbështetjes që ofron spitali Amerikan në Prishtinë. Me entuziazëm ai tregon një ndërhyrje me shpim në veshkë. Se si kanë pastruar një veshkë plot me gurë të bllokuar prej vitesh. Në pamjet pas operacionit, veshka është pastruar komplet dhe pritët që të kthehet në funksionet e duhura për ti ikuar dializes.

Në një rast tjetër të ndërlikuar tregon se si kanë kryer operacion me laparoskop për gjendrën mbiveshkore dhe kanë hequr tumor të veshkës me laparoskop.

Po ashtu flet me passion për një rast tjetër kur kanë bërë thyerjen e gurëve në veshka me lazer me një kamere fleksibile (RIRS) dhe kanë arritur të nxjerrin një sasi shumë të madhe gurësh pa prerje pa shpim.

"Vitet e fundit pothuajse asnjë rast urologjik i rimbursuar nga shteti nuk ka patur nevojë që të dërgohet jashtë Kosovës për trajtim më të avancuar dhe paratë e taksapaguesve kanë ngelur në Kosovë ku janë punësuar rreth 600 punëtorë në dy spitale që operojnë sot. Spitali është bërë një nga pengesat kryesore për pacientet që vizitoheshin në privat dhe më herët shkonin për një analizë urinare në Shkup për konfirmim të ndonjë diagnoze të thjeshtë", - thotë dr. Ajeti.

Gjithkush do të ndjehej krenar ku mëson se këto operacione kryhen prej disa vitesh VETËM në spitalin Amerikan në Prishtinë nga një urolog shqiptar me mbështetjen e një ekipi shumë të madh ku përfshihen instrumentarët, anesteziologët, kardiologët, endokrinologu, ekipa reanimatore e shumë infermierë dhe punonjës te spitalit, të cilët flasin çdo ditë shqip me këta paciente.

Tetë muaj më parë reportazhi i “Reuters” për zbulimin e një rezervuari modest të hidrogjenit natyror në Shqipëri bëri xhiron e botës

ekspertet

Konferencë shkencore për hidrogjenin natyror në minierën e Bulqizës

Miniera e Bulqizës ku është nxjerrë një sasi e konsiderueshme hidrogjeni tërheq vëmendjen e mediave ndërkombëtare

Tetë muaj më parë, Agjencia e lajmeve Reuters i kushtoi një reportazh zbulimit të një rezervuari që përmbante nga 5 mijë deri në 50 mijë ton hidrogjen të bllokuar mes minerës së kromit Bulqizë, i cili mund të ndihmojë në sigurimin e përgjigjeve për reduktimin e emetimeve të gazit në rajon.

Tetë muaj më pas, Bulqiza nuk po lakohet, jo vetëm si një nga minierat më të mëdha të kromit në vendin tonë, por edhe si vendi, nëntoka e së cilës përmban gjithashtu një rezervuar të madh hidrogjeni, një burim potencial i energjisë së pastër.

Nisur nga ky fakt, zbulimi i një rezervuari modest të hidrogjenit natyror në një minierë kromi nëntokësore (xeheror kromi) në Bulqizë dikton domosdoshmërinë e organizimit të një konference shkencore. Për këtë, Prof. Asoc. Dr. Bardhyl Muceku, pasi bën një përmbledhje të shkurtër në lidhje me zbulimin e një rezervuari modest të hidrogjenit natyror në Shqipëri: (ndërkohë që Hidrogjeni natyror, ose gjeo-burim, (H₂) ka tërhequr interes të madh për shkak të potencialit të tij si një burim energjie primar i nxjerrshëm), i është drejtuar zyrtarisht kryetarit të Akademisë së Shkencave, Prof. dr. akademik Skënder Gjinushit, për organizimin e një konference shkencore.

Gjithashtu Prof. Muceku bën të ditur se personalisht ka marrë konfirmimin e Universitetit të Grenoble të Francës «Universite Grenoble Alpes» si dhe të Universitetit Politeknik, ENSEGID të Bordos në Francë, të cilët janë dakort që të sjellin kontributet e tyre në lidhje me këtë konferencë.

“Një studim i fundit, i botuar në revistën Science, trajton në mënyrë specifike këtë çështje të rëndësishme



HALIL RAMA

duke vënë në pah degazimin jashtëzakonisht të lartë të hidrogjenit, të paktën 200 tonë në vit, dhe konstant për të paktën 6 vjet, në një minierë kromi nëntokësore (xeheror kromi) në Bulqizë. Ky është fluksi më i lartë natyror H₂ i matur deri më sot. Një nga manifestimet e tij fizike e shndërron një pellg kullimi të vendosur 1000 m thellë në minierë në një xhakuzi 30 m² që fluskon me H₂ pothuajse të pastër (84 vol%), shprehet ndër të tjera Prof. Asoc. Dr. Bardhyl Muceku në propozimin për Akademinë e Shkencave. Ai argumenton shkencërisht se “Ky degazim i konsiderueshëm natyror ngre çështjen e origjinës së hidrogjenit dhe perspektivat e mundshme ekonomike. Megjithëse kjo rrjedhë është minimale në krahasim me prodhimin

global të hidrogjenit nga industria petrokimike (100 milion ton në vit), vëzhgimet in-situ dhe simulimet numerike të paraqitura nga autorët e këtij studimi tregojnë ekzistencën e një rezervuari të thellë të vendosur në një zonë tektonike”. Kjo sipas Prof. Asoc. Dr. Bardhyl Muceku për faktin se punimet minerare e kanë prekur këtë rezervuar, duke shkaktuar rrjedhje hidrogjeni në vende të ndryshme të lokalizuara mirë në galeritë më të thella.

BULQIZA, OBJEKT STUDIMI SHKENCOR PËR EKSPLORIMIN E HIDROGJENIT NATYROR

Prof. Asoc. Dr. Bardhyl Muceku argumenton se ky zbulim hedh themelet për modele të reja për eksplorimin e

hidrogjenit natyror. Në këtë kuptim, sipas profesorit të mirënjohur Muceku, miniera e kromit Bulqizë, duke ofruar një pamje të drejtpërdrejtë të nëntokës, përbën një mjet shkencor kyç për studimin e sistemit hidrogjenor dhe për të kuptuar kushtet e formimit dhe akumulimit të këtij gazi. “Masivët ofiolitike, formacionet gjeologjike me origjinë nga korja oqeanike (litosfera oqeanike) dhe të transportuara në kontinente me anë të tektonikës së pllakave, duket se janë nikoqirë të mundshëm të këtyre rezervuarëve të hidrogjenit me cilësi të lartë. Këto formacione të mëdha gjeologjike dhe të përhapura në Tokë tashmë janë identifikuar si burime hiperalkaline dhe prani të fluskave të hidrogjenit. Historikisht, ofiolitet nuk kanë qenë objekt i fushatave kërkimore nga industria e naftës dhe gazit, sepse nuk kishin interes për sa i përket burimeve hidrokarbure. Në disa aspekte, ky zbulim mund të jetë një ndryshim i lojës në kërkimin tonë të pandërprerë për burimet e energjisë”, shprehet Prof. Muceku. Gjithsesi, ai pohon se është ende herët të thuhet nëse hidrogjeni natyror do të zërë një vend të rëndësishëm në përzierjen tonë të burimeve energjitike, apo do të mbetet thjesht një kuriozitet. Kjo për faktin se hidrogjeni natyror nuk është një burim i rinovueshëm, në kuptimin që shpejtësitë e prodhimit janë shumë të ngadalta në krahasim me nevojat globale për energji. Përveç kësaj, prof. Muceku argumenton se këto mjedise gjeologjike shpesh strehojnë një biosferë të thellë dhe të brishtë e cila përhapet veçanërisht falë pranisë së hidrogjenit. Por nga ky kënvështrim ai jep gjithashtu një mesazh kujdesi dhe fton një reflektim të thellë mbi ndikimet e mundshme mjedisore të çdo eksplorimi në të ardh-



konferenca kombëtare

SOLIDARIZIM ME POPULLIN DIBRAN,
QË TË NDALET MBYTJA E FUSHËS SË
DRINIT NË DIBËR

Kauza e dibranëve do të fitojë



NGA BASHKIM LAMI

Është me shumë rëndësi bashkimi i dibranëve për ti thënë ndal një investimi që na i përmbyt vlerat e Dibrës tonë. Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" është shprehur publikisht për të qenë të bashkuar, në krah të njëri tjetrit, për çdo rast që dëmtohen interesat e dibranëve dhe të Atdheut. Unë sjell

këtu për të gjithë ju zërin e kryesisë së "Shoqatës Bulqiza" që jemi kundër ndërtimit të hidrocentralit Skavica dhe jemi për ta mbrojtur Dibrën nga përmbytja e të gjenden forma të tjera të investimeve dobiprurëse. Zëri i intelektualëve dibranë dhe i studjuesve e shkencëtarëve të këtij vendi për ne është shumë i qartë se ky investim është jashtë llogjikës ekonomike e sociale dhe argumentat janë dhënë shumë të sakta e të shpjeguara në të gjitha takimet e protestat që janë bërë.

Dua të përgëzoj të gjithë studjuesit që na kanë sjellë argumentat e duhura për të qenë kundër këtij investimi, sot të përmbledhura edhe në librin e botuar për këtë rast. Jemi të befasuar që qeveria që na drejton mban qëndrim të pa justifikuar, për këtë investim. Populli dibran që banon në sipërfaqet që i përfshin ky projekt prej 44 vitësh janë në dilemë që "do bëhet", "s' do bëhet" hidrocentrali dhe jetojnë me stres, që i ka lodhë me pa të drejtë dhe i ka de-

tyruar të kërkojnë me doemos zgjidhje të tjera për jetën, duke lënë trojet e tyre të brengosur, pasi as nuk janë pyetur dhe as nuk u është siguruar e drejta e tyre njerzore mbi pronën, pasurinë, për vlerat e trashëgimisë historike e kulturore, etj. Ky investim përmbyt shumë sipërfaqe toke dhe është jashtë llogjikës ekonomike për energjinë që mendohet të përfitohet. Gjithashtu dhe efektet rregullatore nuk arësyetohen, pasi specialistët i shpjegojnë shumë qartë me argumente shkencore.

Sot ka edhe metoda të tjera të investimit për të prodhuar energji, pa u përmbytur një trevë e tërë, që ne kemi detyrë ta mbrojmë për shumë arsye, prandaj ta dëgjojmë mirë qeveria zërin shkencor e llogjik të specialistëve, por edhe të qytetarëve dhe të heqë dorë nga kjo marrëzi. Mendoj se mbrojtja e fushave të Drinit do të inkurajojë dibranët të kthehen në pronat e tyre dhe të lulëzojnë investimet private në pronat e tyre për bujqësinë, blegtorinë,

pemtarinë, turizmin e veprimtari të tjera ekonomike që do të jenë disa herë më shumë se fitimi i pretenduar nga një koncesionar. Padrejtësia historike e ndau Dibrën, por nuk e zhduku dhe këtë e bën përmbytja, që ne kurrë nuk duhet ta lejojmë të mbulohet fusha e Drinit me ujë. Në emër të kryesisë së "Shoqatës Bulqiza" ju bëj thirrje të gjithë dibranëve kudo që ndodhen dhe të gjithë shqiptarëve, të qëndrojmë të bashkuar për të mbrojtur nga përmbytja pjesën më vitale të vendlindjes tonë.

Bashkohemi në thirrjen ndaj qeverisë të anullop zbatimin e këtij projekti që është në dëm të interesave të popullit të krahinës së Dibrës.

Rroftë e përparoftë populli dibran kudo që ndodhen!

Kauza e dibranëve do të fitojë!

*PËRSHËNDETJA NË KONFERENCËN KOMBËTARE, QË U MBAJT NË TIRANË ME 6 DHJETOR 2024, PËR SOLIDARIZIM ME POPULLIN DIBRAN, QË TË NDALET MBYTJA E FUSHËS SË DRINIT NË DIBËR

Konferencë shkencore për hidrogjenin natyror në minierën e Bulqizës

(Vijon nga faqja 6)

men. "Ky zbulim mund të ripërcaktojë qasjen tonë ndaj burimeve të energjisë dhe hap perspektiva emocionuese për eksplorimin e hidrogjenit natyror. Megjithatë, është thelbësore të vazhdohet kërkimi duke marrë parasysh ndikimin mjedisor dhe qëndrueshmërinë e këtyre nismave", shkruan Prof. Asoc. Dr. Bardhyl Muceku në propozimin drejtuar Kryetarit të Akademisë së Shkencave. Në këtë kuadër ai propozon që Akademia e Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës të organizojnë një konferencë shkencore me titull : "Albanian ophiolites and overlying basins as a case study for H2 exploration", "Ofiolitet shqiptare dhe basenet mbi të si një rast studimor për eksplorimin e H2". Por në mënyrë që të parashikohen «përmasat» e saj, profesori i mirënjohur Muceku kërkon që paraprakisht të analizojnë buxhetin që Akademia mundet të dedikojë për organizimin e saj, duke përfshirë edhe shpenzimet e të paktën tre personaliteteve shkencore ndërkombëtare që do të duhet të marrin pjesë në këtë konferencë.

INXH. NIKO NASKA: HIDROGJENI NË BULQIZË, KARBURANT BËRTHAMOR PËR PRODHIM ENERGIJE

Ing. Niko Naska shprehet se Hidrogjeni i Bulqizës si karburant energjistik duhet të shoqëruar me studime e projekte ndërtimore për prodhimin e energjisë. Nisur nga fakti se shpërthimi i bombës së parë atomike, që u bë më 16 korrik 1945 u ndoq nga bomba me hidrogjen e cila prodhon energji jashtëzakonisht të madhe, Ing. Naska argumenton se "Ndarja e Uraniumit, që bëhet në reaktorët bërthamor për prodhimin e energjisë,ka disa të meta.

Njëra prej të cilave është krijimi i mbeturinave radioaktive. Prandaj përdoren procese të tjera bërthamore të cilat nuk krijojnë sasi shqetësuese mbeturinash radioactive".

Me tej Ing. Naska vijon se "Proçesi më i mirë është ai i bashkimit të bërthamave të atomeve të hidrogjenit. Format e bërthamave të hidrogjenit që paraqesin një interes të veçantë për bashkime të tilla, janë ato të izotopeve

të DEUTERIUMIT, ose të hidrogjenit të rëndë dhe të TRITIUMIT,"si dhe hidrogjeni normal. Kur një bërthamë deuteriumi bombardohet me një bërthamë tjetër deuteriumi çlirohet një energji prej 4000000 ev. Kur një bërthamë tritiumi bombardohet me një bërthamë deuteriumi çlirohet një energji prej 17000000 ev". Sipas ekspertit të njohur Naska, përdorimi i deuteriumit si lëndë djegëse është veçanërisht intere-

sant, sepse një gjashtëmijta pjesë e ujit të zakonshëm përbëhet prej tij. Si rrjedhim, ujrta e oqeanëve përmbajnë rezerva praktikisht të pashtershme të kësaj lënde djegëse të fuqishme bërthamore. Ai argumenton se përparimi i teknikës do ta bënte nxjerrjen dhe përdorimin e deuteriumit shumë të lirë. Kjo, për faktin se tritiumi është radioaktiv dhe paraqet avantazhe për prodhimin e një sasive të madhe energjie.



Këshilli Bashkiak vlerëson gazetarin e shkrimtarin e mirënjohur dhe mësuesin veteran shembullor

nderim

HALIL RAMA DHE SKËNDER MURRJA

“QYTETAR NDERI” TË BULQIZËS

- Ky vlerësim nga Këshilli i Bashkisë Bulqizë, në përbërje të së cilës janë 8 Njësi Administrative: Qyteti i Bulqizës, Fushë Bulqiza, Zerqani, Shupenza, Gjorica, Ostreni, Trebishti dhe Martaneshi, vjen në konsiderim të propozimit nga OBVLP dhe Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe me propozimin e kryebashkikes Festime Mjeshtri, në emër të qytetarëve të Bulqizës

Në një ceremoni madhështore me praninë e më shumë se 300 pjesëmarrësve, qytetarë, personalitete të letrave, artist e Kulturës, mësues, maturan të gjimnazit të Bulqizës, punonjës të administratës vendore etj, që kishin mbushur kinemanë e qytetit minator, gazetari e shkrimtari i mirënjohur Halil Rama dhe mësuesi veteran shembullor Skënder Murrja janë vlerësuar të enjten e 14 Nëntorit 2024 me titullin “Qytetar Nderi” i bashkisë Bulqizë.

Ky vlerësim nga Këshilli i Bashkisë Bulqizë, në përbërje të së cilës janë 8 Njësi Administrative: Qyteti i Bulqizës, Fushë Bulqiza, Zerqani, Shupenza, Gjorica, Ostreni, Trebishti dhe Martaneshi, vjen në konsiderim të propozimit nga OBVLP dhe Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe me propozimin e kryebashkikes Festime Mjeshtri, në emër të qytetarëve të Bulqizës. Vlerat e dy personaliteteve që iu dha titulli më i lartë që jep Këshilli Bashkiak, u evidentuan më së miri nëpërmjet dy dokumentarëve që u ndoqën me interes të veçantë nga pjesëmarrësit.

Pas vlerësimit që ju bëri kryebashkiakja Mjeshtri dy personaliteteve, Zotërinjtë Rama e Murrja i shprehën asaj mirënjohje të veçantë për përkushtimin dhe vizionin bashkëkohor me të cilin drejton Bashkinë e Bulqizës, duke realizuar një transformim rrënjësor në infrastrukturë dhe duke ndikuar në realizimin e veprimtarive të larmishme në kuadrin e 80 vjetorit të çlirimit të atdheut. Ceremonia u moderua me mjeshtri të rrallë artistike nga ikona e skenës dhe ekranit, Mjeshtri i Madh Llesh Nikolla, ndërkohë më të larmishëm e bënë këtë event me performancën e tyre artistike, këngëtar i talentuar Dritan Jashari – Nderi i Kulturës Dibrane, si dhe valltarët e Qendrës Kulturorë të Fëmijëve Bulqizë.



HALIL HIDËR RAMA, GAZETAR DHE SHKRIMTAR PROFESIONIST

Halil Rama u vlerësua me titullin “Qytetar Nderi” i bashkisë Bulqizë për kontributin e tij “Si shkrimtar, skenarist e publicist, i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Bulqizës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”.

Marrëdhëniet e tij me qytetin e Bulqizës nisën që vitin 1987 si metodist i kulturës në Shtëpinë e ushtarakëve, për të vijuar më pas si Sekretar i Komitetit Ekzekutiv Pulualist të Këshillit të Qytetit dhe si Shef i Administratës së Këshillit të Rrethit Bulqizë nga viti 1991 deri në vitin 1998.

Ka jetuar këtu për 11 vjet me familjen e tij dhe ka krijuar profilin e një kuadri e intelektualit me reputacion, të devotshëm, të nderuar e të respektuar nga qytetarët e Bulqizës.

Është themelues dhe drejtues i gazetës “Bulqiza” që më 5 maj 1992 e në vazhdim deri më 1998 dhe ka rinisur botimin e saj sërish nga viti 2010 e në vazhdim, ku me kompetencë e profesionalizëm ka pësquar zhvillimet e vullshme të Bulqizës, historinë, traditat dhe personalitetet e saj. Gjithashtu ai drejton gazetën “veteran” si kryeredaktor i saj prej 22 vitesh. Në këtë gazetë si dhe në gazetën qendrore “PANORAMA”, “DITA”, “GAZETA SHQIPTARE”, “TELEGRAF” etj ka botuar çdo 18 shkurt historinë e gjerë në minierë së Bulqizës, si dhe në vijimësi ka pasqyruar veprimtarinë e OBVLP. Në 27 librat e tij (letërsi dokumentare+poezi dhe tregime) si dhe si skenarist e regjisor i 9 dokumentarëve televizivë Halil Rama

prezantohet si mjeshtri i profilit, duke krijuar personazhe si shëmbëlltura që të mbeten në kujtesë.

Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtri di të përveçojë protagonistët të veshur me detaje, që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshhtërisht.

SKËNDER RAMIZ MURRJA, MËSUES VETERAN SHEMBULLOR

“Eshtë i njohur për kontributin e dhënë në zhvillimin e sektorit të arsimit në Bashkinë e Bulqizës e atë të Dibrës, i cili për 42



vjet, si mësues, drejtore shkolle (20 vjet në shkollat e Dibrës dhe 22 vjet në Bulqizë), inspektor dhe Drejtor i Zyrës Arsimore Bulqizë ka krijuar një karrierë të shkëlqyer profesionale dhe intelektuale. Eshtë dalluar për profesionalizëm, përkushtim dhe vizion bashkëkohor”. Ky është motivacioni

që shoqëron Titullin “Qytetar deri” i Bashkisë Bulqizë.

Nga strukturat përkatëse drejtuese në qarkun e Dibrës e Bashkinë e Bulqizës S.Murrja është vlerësuar për rritjen e nivelit në formë e përmbajtje, të punës së komisioneve kualifikuese në bazë shkolle e rrethi, për t’ju dhënë zgjidhje problemeve të përmbajtjes së punës me nxënësin.




Si ekspert shembullor ai ka ndikuar në ngritjen e nivelit të veprimtarive me nxënësit cilësorë për t’ju përgjigjur me sukses kërkesave në arsimin e mesëm dhe të lartë. Ndërkohë ka realizuar studimin e mirëfilltë të punës me kuadrin për t’ju përgjigjur në kohë e me cilësi kërkesave të punës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Gjatë karrierës së tij 42 vjeçare si mësues dhe drejtues në disa shkolla e institucione arsimore, Skënder Murrja ka marrë vlerësime maksimale, deri edhe nga Ministria e Arsimit. Kështu, më 16.04.1984 ai është vlerësuar nga Ministria e Arsimit Tefta Cami me Distinktivin “Mësues i Dalluar”, me motivacionin: “Për përgatitje të mirë ideologjike,shkencore e pedagogjike, për punë të ndërgjegjshme dhe për arritje të larta në procesin mësimor-edukativ.

Më 01.04.2002. ka marrë Certifikatën: “Shkolla pilot në Edukimin e të Drejtave të njeriut, një eksperiencë e re pune” nga Drejtore ekzekutive e QSHDNJ Kozara Kati dhe Drejtore e IS: Erlehta Mato. Skënder Murrja është vlerësuar edhe me Certifikatën “Për kontributin e dhënë në lëvizjen sindikale në arsim” (më 26.04.2016.) nga Kryetari i FSASH Xhaferr Dobraçsi. Për 11 vite (2008-2019) ka qenë Kryetar i FSASH (Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës) për bashkinë Bulqizë.



Kica ka shpallur se vë në qendër të studimeve të tij burimet origjinale rreth ngjarjeve e figurave historike

reçenca



Ramazan Kica dhe kolana e tij për historinë e Skënderbeut dhe të Dibrës

SALI ONUZI

Pak kohë më parë ne gjysmën e dytë të këtij viti, doli në qarkullim libri i studiuesit Ramazan Kica, "Historia e Dibrës dhe e Dibranëve".

Ky libër i shtohet dhe është pjesë përbërëse e kolanës së autorit për historinë e mesjetes shqiptare, në veçanti asaj të Skënderbeut dhe të Dibrës. Njëri pas tjetrit janë shkruar, botuar e dalë në qarkullim librat e Kicës: "Beteja e parë e Skenderbut" (2017), "Beteja e parë dhe e katërt e Skenderbeut me Ballabanin", (2020) "Sfetigradi - fundi i një enigme" (2021); "Modrisa", (2022) "Qyteti i Bardhë" (Albanopolis) me 2023 dhe tani 2024 "Historia e Dibrës dhe e dibraneve" dhe "Nga ishin kastroitët". Pra, 7 libra për 7 vjet. Kjo tregon se autori ka bërë me kohë një punë të madhe përgatitore, ka krijuar një sfond të përgjithshëm dhe pastaj e ka trajtuar në disa nga të veçantat e tij. Natyrisht, në çdo botim të Kicës ka trajtime të thelluara e konkrete, po kudo duket një bosht i përbashkët.

Kemi këtu një kolanë librash, me Dibrën dhe Skënderbeun në qendër të tyre. Autori ka krijuar një lloj akademie të tij për këtë temë skënderbejane e dibrane. E lidhur qartë me parimet kryesore dhe gjetjet më të mëdha të historiografisë shqiptare, Kica ka sjellë për temat që ka trajtuar një pamje të re, një vështrim tjetër, më konkret e më të qartë. Mbi të gjitha tek ai nuk gjen kundërthënie. Librat e tij vijojnë të argumentojnë njëri tjetrin. Janë të kapur si vargmal, dorë për dorë dhe si fushat me shtretërit e lumenjëve etj. Në këtë pikë qëndron edhe origjinaliteti i tij, më saktë, saktësia e tij.

Duket se Kica u ka hyrë studimeve dhe librave pikërisht për të saktësuar disa emra dhe ngjarje të mëdha të historisë sonë mesjetare.

Sa herë është ndërruar deri tani vendodhja e Sfetigradit, apo e Betejës së parë të Skënderbeut me Balla-

• Ramazan Kica e ka kaluar periudhën e martirizimit politik në sistemin e kaluar. Kohët e reja, teknikat e reja moderne të kërkimit, e drejta e fjalës dhe liria e shprehjes, e kanë armatosur atë t'u futet atyre shtigjeve që ende nuk janë hulumtuar si e sa duhet

banin, vendndodhja e Mokrës, apo e Albanopolit(?!).

Natyrisht kjo ka një farë justifikimi, me prapambetjen e studimeve tona historike para shekullit të XX, deri diku edhe pas tij, po edhe me natyrën e historiografisë që ka nevojë për një kohë për të zbuluar të vërtetën.

Për Kicën ka rëndësi që të saktësohen vendndodhjet e ngjarjeve, të kalave, që qyteteve, të rrugëve etj. Për këtë ai u drejtohet burimeve të vjetra antike dhe i ndjek ato nëpër shekuj, se si kanë ndryshuar madje deri në ditët tona, për shumë arsye historike, sidomos edhe të pushtimeve të njëpasnjëshme. Prandaj Kica ka shpallur se ai vë në qendër të studimeve të tij burimet origjinale rreth ngjarjeve e figurave historike, dhe nuk merret pothuajse fare me interpretuesit e tyre të mëvonshëm edhe kur ata janë autoritet në atë lëmë të dijës. Pa le kur janë si Xhamharia Biemi, një mashtrues profesionist që shpik vende dhe ngjarje!

Autori ka gjetur edhe metodën efikase për të realizuar këto studime. Ndërsa i studion ngjarjet e figurat, ai bën çmos t'i vendos ato në kohën e caktuar dhe në vendin e vet. Kjo për të është thelbësore. Ai kështu ka shkruar në fakt edhe një histori të gjeografisë ushake. Koha dhe vendi (relievi), këto dy faktorë të pathyeshëm e kanë çuar Kicën në Fushën e Korabit më 1444 kundër Ali Pashës, në Kalanë e Modrisës, në Mokrën poshtë Shkupit, në Sfetigrad te malet e Peristerit, e kanë çuar në Valikardhë për betejat kundër Ballabanit dhe prapë në Valikardhë për qytetin e Albanopolit.

Po me këtë metodë ai arrin edhe të përcaktojë rrugën e dërgatës së Per-

seut për në Shkodër te Genti, edhe zotërimet e Kastriotëve në Mat. Prandaj Kica shkruan se "qyteti Dobera (i Ptolemeut) që ekzistonte në shekullin V para erës sonë, kampi i Kastriotit në Dibër të Sipërme dhe kalaja Belçe në kodrën Straishta janë e njëjta gjë në kohëra të ndryshme".

Me kompasin e tij mat kohën e ngjarjeve dhe e përplas atë mbi terrenin shqiptar, që është po ai i kohëve të mesjetës, dhe që është një orintues i pavdekshëm. Kështu ai na tregon ku shtriheshin helidonët, pse Uskana e penestëve bie në rrënojat e Grazhdanit të sotëm, ku banonin stefanakisit, ku bie Iliria e shkretuar, ku kanë qenë dardhanët në Dibrën e Poshtëme, po fisi i Bardhëve, po qyteti Oenea (Stelushi apo qyteti i Skënderbeut) etj.

Ramazan Kica nuk beson aq lehtë. Nuk i ndjek kohën dhe vendin vetëm në letër e në libra. Ai me një grup miqsh të tij mendjehapur, ish kolonellë të Ushtrisë, kanë bërë ekspedita të njëpasnjëshme në ato vende historike për të cilat shkruan. Edhe termat historikë e gjeografikë, bën çdo përpjekje t'i zbërthejë nga pikëpamja gjuhësore, falë edhe njohjes së tij të disa gjuhëve edhe të vjetra.

Kica është një studiues i përgjegjshëm e korrekt. Nuk vetmburret e nuk lëshon rrufe ndaj të tjerëve. Madje edhe kur gjen një detaj të ri, a një kohë a një vend të ri, Kica i vlerëson kontributet e të tjerëve për keto tema. Madje ai është lodhur duke bërë thirrje që për këto gjetje të reja të thotë fjalën e saj arkeologjia, linguistika, etj. Po në fakt institucionet shkencore tona nuk preken nga këto kërkime, gjetje e përfundime të Ramazan Kicës,

meqë ai nuk ka një gradë shkencore (!). Më duket se disa prej tyre janë mbyllur në kullat e ngurta që kanë krijuar vetë, dhe nuk kërkojnë e vlerësojnë mendimin e gjetjet e vërteta e të reja. Ato i trullojnë titullin e grada shkencore edhe atëhere kur doktori i shkencave thotë me kryelart se vetëm demokracia pjell antifashizëm, edhe kur tjetri thotë se antifashizmi shqiptar i ka rrënjët në kryengritjet e shekullit të XIX, kur fashizmi vetë ka lindur një shekull e ca më vonë.(!)

Në historinë e shkencës botërore ka jo pak raste që dijetarët zyrtarë janë mbajtur pas "tokës së sheshtë", (madje ka edhe sot të tillë), dhe që kanë djegur e internuar dijetarët e vërtetë. Po historia e shkencës këtyre martirëve u ka dhënë të drejtë.

Ramazan Kica e ka kaluar periudhën e martirizimit politik në sistemin e kaluar. Kohët e reja, teknikat e reja moderne të kërkimit, e drejta e fjalës dhe liria e shprehjes, e kanë armatosur atë t'u futet atyre shtigjeve që ende nuk janë hulumtuar si e sa duhet.

Unë kam pasur rastin a fatin të jem disa herë konsulent, reçenzent a redaktor i disa librave të Ramazan Kicës dhe e di se sa serioz është ai në punën e tij. Askush i vetëm nuk e ka zbuluar historinë e botës, a të popujve dhe vendeve të ndryshme. Kica si çdo studiues është sa kërkues aq dhe realist. Edhe sikur disa nga gjetjet e tij të mos i rrezistojnë kohës, Ramazan Kica, e ka thënë fjalën e tij me dinjitet, me argumente mbi dokumente e fakte të njohura deri më sot dhe është futur në listën e autorëve seriozë.

Me këtë rast unë i uroj Ramazan Kicës, punë të mbarë e gjetje të reja!

Mesazhe atdhetarie nga romani “Kalorësi i Skënderbeut”



Beqir Ajet Shehu*

Në historinë e letërsisë shqiptare, Haki Stërmilli përfaqëson shkrimtarin demokrat, jeta dhe veprimtaria e të cilit u lidh ngushtë me fatet e atdheut dhe të luftës së forcave patriotike e revolucionare për një Shqipëri të lirë, të bashkuar dhe të përparuar. Haki Stërmilli përjetoi pasojat e ngjarjeve më dramatike në historinë e popullit shqiptar e në veçanti të Dibrës, vendlindjes së tij. Traditat patriotike dhe jeta e pasur zakonore në vendlindjen e tij, atmosfera që krijuan në Dibër zhvillimet e vrullshme të lëvizjes patriotike të atdhetarëve të shquar dibranë Hoxh Voka, Dervish Hima, Josif Bageri e të tjerë, si dhe rënja e Dibrës nën robërinë e pushtuesve serbë dhe pasojat e tmerrshme që i sollën vendit, masakrat shtazore mbi popullsinë e pafajshme, qenë atmosfera ku i riu Haki Stërmilli, u rrit u shkollua dhe u formua për të marrë përsipër detyrën e vështirë të dalzotësit ndaj vendit e njerëzve të tij.


Sapo mbaroi gjimnazin në Manastir, ku qe dërguar me ndihmën e interesimin e patriotit Dervish Hima, bëhet një prej drejtuesve kryesorë të shoqërisë “Djelmënia Dibrane” e cila zhvilloi një veprimtari të guximshme patriotike mes vëllezërve të vendlindjes.

Pas Kongresit të Lushnjes, Haki Stërmilli vendoset në Tiranë, në administratën e shtetit të ri dhe merr anën e lëvizjes rinore përparimtare në luftën e ashpër mes forcave politike që zhvillohej në atë kohë. Haki Stërmilli u bë një nga militantët më të shquar të lëvizjes demokratike të rinisë dhe si drejtues i shoqërisë “Bashkimi”, mori pjesë me armë në dorë në ngjarjet e Revolucionit të Qershorit 1924, për të sjellë në fuqi një qeveri demokratike. Pas rënies së qeverisë së Fan Nolit, Haki Stërmilli, si shumë patriotë demokratë, u detyrua të emigronte në disa shtete të Europës e duke qenë edhe anëtar i “KONARE-së”, nuk e ndërpreu asnjëherë veprimtarinë e tij patriotike revolucionare në interes të atdheut e kombit.

Në vitin 1929, me ndërhyrjen e Ahmet Zogut, qeveria jugosllave ktheu në Tiranë Haki Stërmillin dhe Zogu e burgosi, duke mos marrë në konsideratë as protestën e “KONARE-s”, të nënshkruar edhe nga personalitete, si shkrimtari Henri Barbys, fizikati Ajnshtajni, Sen Katajama e shumë deputetë e profesorë nga të katër anët e botës.

E VËRTETA E DITËS SË ÇLIRIMIT NË DITARIN E HAKI STËRMILLIT

Pushtimin fashist të vendit, të cilin e kishte parashikuar në një artikull të botuar në gazetën “Liria Kombëtare”, Haki Stërmilli e priti me shumë trishtim. “Okupacioni fashist - shkruan ai’ - më egërsoi tepër.Deri në Konferencën e Pezës punova ashtu si ma muer mendja se mund t’i shërbejsha popullit e atdheut. Mbas Konferencës u rrjeshtova në Kampin e Frontit Nacional Çlirimtar”. Dhe ashtu veprroi. Megjithëse e kishte kaluar moshën e veprimeve të guximshme, në verën e vitit 1943 u hodh në radhët e luftës partizane duke përballuar vështirësi, rreziqe e beteja deri në ditën e çlirimit të vendit. Dhe ja çfarë



shkruan në ditarin e tij më 28 nëntor 1944 luftëtari i shquar, shkrimtari demokrat, Haki Stërmilli: “Në këtë ditë feste, dy herë historike, sytë e zemrave të popullit tonë drejtohen kah vorret e mija, të dëshmorve që siguruen fitoren, dhe me gjakun e tyre të pastër shkruen një epope të madhnueshme”. Pasi përshkruan aktivitetet e kësaj dite, dy herë historike, duke filluar që nga ora 10’30, me daljen e Komandantit Enver Hoxha me Qeverinë Demokratike, ku nga trbuna e ngritur para Hotel Dajtit, përshëndeti parakalimin e 15 mijë djemve e vajzave të brigadave partizane”, ditarin e kësaj dite feste, dy herë historike, e përfundon me fjalinë “Festa vazhdon”.

Citova fletë ditarin e kësaj dite dy herë historike pasqyruar në “Ditarin Partizan” të Haki Stërmillit, për dy arsye.

Së pari, se e gjithë veprimtaria e tij, si shkrimtar dhe si luftëtar me armë në dorë, lidhet me këto dy shtetë: Shpalljen e Pavarësisë dhe Çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashist..

Së dyti, kremtimi i 28 nëntorit 1944, si “ditë dy herë historike”- dita e shpalljes Pavarësisë dhe dita e Çlirimit të vendit nga okupacioni fashist, të pasqyruara në këtë fletë ditarin, nga historiani dhe shkrimtari Haki Stërmilli. është një dekument i vërtetë shkencor për historinë.

Rruga e jetës së Haki Stërmillit ishte rruga e jetës së një luftëtari të shquar, i cili tërë qenien e tij fizike e shpirtërore, tërë aftësitë e talentin e tij i vuri në shërbim të luftës për çlirimin e vendit, për ruajtjen e forcimin e identitetit kombëtar, si edhe për demokratizimin dhe prosperitetin e tij. Pjesë e kësaj lufte, madje edhe më e rëndësishmja, që e veçon Haki Stërmillin, është vepra e tij letrare.

Një ndër veçoritë më të spikatura në veprën letrare të Haki Stërmillit është lëvrimi i temës patriotike. Duke qenë nën përshtypjen e ngjarjeve tragjike të zhvilluara në vendlindjen e tij, dhe duke i pëjetuar ato edhe personalisht, si dhe duke i gërshetuar këto me ngjarje e probleme të jetës zakonore, Haki Stërmilli, jo vetëm që na ka dhënë vepra dinjitoze me vlera të veçanta ideo-artistike, por na ka lënë edhe një arkiv vlerash me të vërteta historike për njohjen e jetës dhe të zhvillimeve të kësaj periudhe.

SFONDI I NGJARJEVE HISTORIKE NË ROMANIN “KALORSI I SKËNDERBEUT”

Në këtë trajtim të shkurtër duam të veçojmë disa nga vlerat e romanit historik “Kalorsi i Skenderbeut”, jo vetëm se është shkruar më pak për të, por na intre-

• Haki Stërmilli shkruan në ditarin e tij: “Mbas Konferencës së Pezës u rrjeshtova në kampin e Frontit Nacional Çlirimtar me besimin se kohët kishin ndyshuar dhe kjo luftë do të çlironte vendin nga fashizmi dhe do të realizohej edhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë”. Besimi i tij se do të realizohej kjo zgjidhje shprehet edhe në fletën e ditarit të datës 29 nëntor 1944, ku thotë: “Divizionet tona çliruan Prishtinën dhe po marshojnë drejt Kosovës”. Por edhe lufta Nacionalçlirimtare nuk i realizoi pritmeritë e luftëtarit patriot, ashtu si edhe të gjithë popullit shqiptar: Dy të tretat e trojeve shqiptare, ku bënte pjesë edhe Dibra e Madhe mbetën pësëri jashtë kufijve të shtetit shqiptar



gon edhe fakti: Përse Haki Stërmilli, e ndërpreu në vitin 1941, shkrimin e këtij romani dhe filloi përsëri ta shkruante në vitin 1952.

Romani “Kalorësi i Skënderbeut” është ndër-tuar mbi sfondin e ngjarjeve të vërteta historike të viteve 1451 - 1456, kur populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut luftonte trimërisht për mbrojtjen e tokave të shtetit shqiptar dhe për çlirimin e viseve të tjera të trojeve arbërore, të pushtuara nga osmanët, siç ishte edhe Kalaja e Sfedigradit. Duke hyrë në rrjedhën e ngjarjeve të kohës nëpërmjet të dhënave historike dhe traditës popullore, Haki Stërmilli ka arritur të na pasqyrojë atmosferën heroike të atyre viteve, duke na treguar se ndërgjegjësimi patriotik i popullit ishte elementi thelbësor i sjelljes së kësaj atmosfere. Malësorët e thjeshtë trima e fisnikë ishin ata që përbënin ushtrinë e Skënderbeut e cila përballon me sukses hordhitë osmane. Këta malësorë trima janë edhe mbartësit e traditës dhe të zakoneve të tyre fisnike, pjesë e jetës së tyre të përditshme, që i trasmetojnë nga brezi në brez, dhe i ruajnë me fanatizëm si pasurinë e tyre më të shtrejtë. Protagonistët kryesorë të romanit nuk janë marrë nga figura historike por nga bijtë e popullit. Të tillë janë: Mark Spani (Kalori i Bukur) - protagonist kryesor i romanit, pjesëtar i Gardës Pretoriane të Skënderbeut, i cili mishëron veti e vrytyte të luftëtarëve të kësaj epoke. Ai është: trim e besnik, kalorës fisnik, dashnor zemërzjarr, luftëtar i devotshëm i kauzës së shenjtë të atdheut.

Mira Mireshi, bija e luftëtarit të paepur të lirisë Zef Mireshi, vajza fytyrhënë me zemër të bardhë, besnike e dashurisë së pastër e të sinqertë me Kalorsin e bukur, por edhe luftëtarë e patrembur dhe e vendosur në mbrojtje të lirisë e të jetës së kryet-

Tre vjet më parë (14 gusht 2021) fitorja e titullit Kampion bote në kikkoks e ngjiti Ferit Ketën në majën e piramidës së këtij sporti të shumëpreferuar anë e mbanë rruzullit.

ndeshja

Ferit Keta shkruan historinë, mbron titullin botëror në kikkoks

ADRIATIK BALLA

Ferit Keta mundi mbrëmjen e së shtunës të 15 dhjetorit 2024 vonë, rivalin e tij Ernest Dupljak, në kuadër të titullit botëror në kikkoks. Në fakt, ndeshja ishte kërkuar nga rivali i tij luksemburgas dhe sportistit tonë kuqezi i duhej të zbriste në ring për të mbrojtur titullin që e kishte fituar disa vite më parë në një duepl të fuqishëm në kalanë e Bashrovës kundër holandezit Blokland. Kjo ndeshje që bëri Feriti ishte spektakolare. Ai nuk i la kundërshtarit asnjë shans që të përgjigjej, duke e bllokuar në çdo drejtim dhe duke e detyruar të kapitullonte pa kushte. Goditjet e Feritit ishin të tilla që e demoralizuan kundërshtarin dhe fitorja ishte bindëse dhe kundërshtari pësoi edhe dëmtime të rënda.

Trajneri Ismail Keta ka përcjellë një mesazh të shkurtër por domethënës për suksesin e vëllait të tij Ferit Keta, duke ua dedikuar këtë sukses bashkëatdhetarëve kudo janë, por duke mos harruar të falënderojë bacën Rifat Jashari që është tifoz special i vëllezërve Keta. "Mirmbrëma miq dhe bashkëatdhetarë! Desha të ndaj me ju disa emociione të mbrëmjes së djeshme sportive në Mynih. Ishte një mbrëmje me emociione të ndryshme nga vlerat sportive të nxënësve të mi, për tu quajtur edhe e sukseshme.

Vëllai Feriti, ishte i pregaditur fizikisht dhe moralisht. Akoma më shumë me praninë e Bacës Rifat dhe bashkëatdhetarë nga mbarë trojet shqiptare, sa që deditjet e tij varre,



sollën dëmtim serioz kundërshtarit që në raudin e parë. Por jo gëzim maksimal për Feritin i cili rimbajti titullin, pasi donte si gjithmonë të tregonte spektakël dhe vlera sportive për fansat, e bashkëfshatarëve. Faleminderit bashkëatdhetarëve", shkruan Ismail Keta në llogarinë e tij në rrjetin social "facebook" më 17 dhjetor 2024. Sukseset e Feritit janë madhështore dhe me siguri që do të vijojnë edhe më tej.

• Trajneri Ismail Keta ka përcjellë një mesazh të shkurtër por domethënës për suksesin e vëllait të tij Ferit Keta, duke ua dedikuar këtë sukses bashkëatdhetarëve kudo janë



FERIT KETA NA BËRI MË KRENARË SE KURRË...

Tre vjet më parë (14 gusht 2021) fitorja e titullit Kampion bote në kikkoks e ngjiti Ferit Ketën në majën e piramidës së këtij sporti të shumëpreferuar anë e mbanë rruzullit. FITORJA e kësaj ndeshje në Kalanë historike të Bashrovës, përballë Guillerme Blokland - kampion bote, që u ndoq nga qindra mijëra sportdashës, e ku ishin të pranishëm dhjetra personalitete, si presidenti Alfred Moisiu, ish - kryeparlamentari i RMV Talat Xhaferi, ish -

Ministrja e Arsimit Evis Kushi, pinjollit i Jasharajve, Rifat Jashari, gazetari i mirënjohur Marin Mema, tenori Kastriot Tusha etj, na ka bërë më krenarë se kurrë. Padyshim që meritë për këtë ka dhe trajneri Ismail Keta, një nga personalitetet shqiptare me famë botërore në botën e sportit.

Më krenarë se kurrë edhe me mikun tonë Defrim Methasani, që si ikonë e gazetarisë sportive e moderoi me mjeshtri të rrallë këtë event historik, duke i dhënë kalasë së Bashrovës atë gjallëri që s'e ka parë e ndërjer shekuj më parë...

Mesazhe atdhetarie nga romani "Kalorësi i Skënderbeut"

(Vijon nga faqja 10)

rimit, mbretit të shqiptarve, Skënderbeut.

Këto figura e të tjera, si ajo e Hil Veshkuqit, e Qerimit dhe e motrës së tij, të ndërthurura me ngjarje e situata ku pasqyrohet atmosfera patriotike që rrethon popullin e ngritur në luftë, tregojnë edhe fatin e të rinjve dibranë, fati i të cilëve ishte pleksur me fatet e Dibrës dhe të të gjithë vendit. Figurën e Skënderbeut në roman, për mendimin tim, shkrimtari Haki Srërmilli, na e ka dhënë sipas modelit të shkrimeve për profetin Muhamed. Ndonëse është një figurë episodike, ai ndiehet në të gjithë romanin. Shkrimtari nuk e ka trazuar kryezotin me intrigat e aventurave dashurore, që ndodhin në trajtesën e romanit. Populli e quan atë diell që ngroh çdo zemër shqiptare. Në roman nënvizohet, jo vetëm misioni historik i Skënderbeut në luftë për tu bërë ballë agresorëve, por edhe për të krijuar një shtet të përqendruar shqiptar.

Në romanin "Kalorësi i Skënderbeut", pasqyrohen edhe prirjet separatiste të kohës të cilat kanë gjetur shprehje në trajtimin e dy figurave historike të kohës - Moisi Golemi dhe e shoqja princeshë Zafina. Duke pohuar të vërtetën historike të tradhtisë e të pendimit të princit të Dibrës, Moisi Golemit, dhe rolin intrigues të princeshës Zafina në këtë tradhti, autori jep mesazhin: Të kihet kujdes, se shkak i joshjes drejt separatizmit e tradhtisë ndaj interesave të atdheut janë po ato elemente e faktorë, që i kanë sjellë zhvillimet historike, që nga agimet e shoqërisë njëzore.

Dua të ndaj me lexuesin, mendimin tim: Përse shkrimtari Haki Stërmilli, romanin "Kalorësi i Skënderbeut", që kishte nisë ta shkruante në vitet 1937-38, e ndërpreu në vitin 1941, dhe filloi ta shkruante pas Luftës së Dytë Botërore dhe e përfundoi në vitin 1952. Haki Stërmilli ishte burrë me vizion të largët politik dhe njohës i shkëlqyer i gjeopolitikës, vçanërisht asaj në Ballkan. Vendimet e padrejta të

Fuqive të Mëdha për copëtimin e tokave shqiptare, ku përfshihej edhe ndarja e Dibrës në dy pjesë dhe lënia e Dibrës së Madhe me trojet e tjera shqiptare jashta kufirit të shtetit shqiptar, vendosur më 1913, tronditën pa masë edhe zemrën e shkrimtarit patriot, ashtu si të gjithë popullit shqipëtar. Pritmëria se me përfundimin e Luftës Parë Botërore do të rregullohej kjo padrejtësi, jo vetëm që nuk solli zgjidhje, por mbylli dhe shpresat. Kjo bëri që detyrat e shtetit shqiptar por edhe të shoqërisë shqiptare të ishin po ato të viteve 1451-1456, me ndryshimin e vetëm - atë të pushtuesit, nga turk në sllav. Ndaj në vitet 1937-38, Haki Stërmilli filloi të shkruante romanin historik "Kalorësi i Skënderbeut", shkrimin e të cilit i ndërpreu me fillimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe konkretisht pas prillit të vitit 1941, kur u realizua bashkimi i trojeve shqiptare në një shtet të vetëm me qendër në Tiranë.

NDËRGJEGJËSIMI PATRIOTIK I MASAVE POPULLORE PËR DOMOSDOSHMERINË E BASHKIMIT KOMBËTAR

Haki Stërmilli shkruan në ditarin e tij: "Mbas Konferencës së Pezës u rrjeshtova në kampin e Frontit Nacional Çlirimtar me besimin se kohët kishin ndryshuar dhe kjo luftë do të çlirohte vendin nga fashizmi dhe do të realizohej edhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë". Besimi i tij se do të realizohej kjo zgjidhje shprehet edhe në fletën e ditarit të datës 29 nëntor 1944, ku thotë: "Divizionet tona çliruan Prishtinën dhe po marshojnë drejt Kosovës". Por edhe lufta Nacionalçlirimtare nuk i realizoi pritmeritë e luftëtarit patriot, ashtu si edhe të gjithë popullit shqiptar: Dy të tretat e trojeve shqiptare, ku bënte pjesë edhe Dibra e Madhe mbetën pësëri jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Kjo ishte dhimbja më e madhe e këtij luftëtari të paepur. Por me gjithë këtë dhim-

bje, me gjithë rëndimin e viteve e lodhjes që i solli lufta trevjeçare në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shkrimtari patriot nuk dorëzohet. Ai i rikthehet shkrimit të romanit, e përfundon atë, duke na bërë me dije se detyra nuk kishte mbaruar dhe me gjuhën e Dibrës, do të sugjeronte edhe rrugët për realizimin e saj -, në radhë të parë ndërgjegjësimi patriotik i masave popullore, që të viheshin në lëvizje për të realizuar bashkimin e trojeve shqiptare.

Nuk ndaj të njëjtin mendim edhe për kritikën që i bëhet veprës së Haki Stërmillit, sidomos asaj të viteve të mbretërisë, kur thuhet se kufizimet botëkuptimore nuk e kanë lejuar shkrimtarin që në krijimtarinë e tij të shtrojë nevojën e përmbykses së rendit shoqëror ekzistues, por kufizohet vetëm në mohimin e disa normave të moralit dhe mentalitetit sundues të kohës. Unë mendoj se nuk janë kufizimet botëkuptimore, por vizioni dhe symprehtësia e shkrimtarit, që i lexonte në thellësi zhvillimet gjeopolitike të kohës, për të mos përdorë "grushtat migjenian" për rrëzimin e monarkisë.

Shkrimtari patriot e kishte të qartë se në vitet "30, kur të gjitha shtetet e Ballkanit ishin monarki dhe kur synimet e tyre grabitqare ishin në rend të ditës, rrëzimi i monarkisë do të ishte një rrezik real për copëtimin e plotë të tokave shqiptare. Ai e kishte të qartë gjithashtu, se monarkia do të ishte një siguri më e madhe për ruajtjen e pavarësisë së shtetit të ri shqiptar. Haki Stërmilli, kur viheshin në rrezik interesat e atdheut e të kombit, për të cilat kishte luftuar gjithë jetën, me gjithë kundërshtitë që kishte me Mbretin Zog, dhe persekutimin që ai i kishte bërë, nuk do t'ia lejonte vetes kurrë që veprimtaria e tij të cënonte interesat madhore të kombit.

**Studjues - "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" i Institutit të Studimeve Historike të Akademisë së Shkencave - Tiranë, që nga viti 1978

FAJI ËSHTË I URDHËRUESIT TË LUFTRAVE

Tregim nga Sakip Cami

Drini, ishte lumi shekullor me të cilin këto banorë kishin lidhur jetën. Fshati Visiart shtrihet midis lumit të Drinit të Zi dhe Zallit të Mullkastrës, një shtrirje malore me kodra të shumta e të rrumbullakta, me përrenj e gjirize[1] të shumtë. Ky fshat kishte katër lagje, Visiart i poshtëm, Visiart i sipërm, Goldvis dhe Burim. Kjo e bënte që përhapja e tij të ishte shumë e madhe në raport me numrin e banorëve. Por kjo ishte gjë e mirë sepse çdo banori i takonte pak fushë, pak mal, pak lumë, pak pyll, pak djerrishtë, pak lajthishtë dhe shumë pemë e perime, shumë të ardhura nga natyra e begatë. Jo më kot nuk i thonin Visiart. Dyndjet sllave në shekullin e gjashtë deri në shekullin e dymbëdhjetë nuk ja ndryshuan dot as emrin. Deferët e vjetër shënonin emra të tjerë, ndërsa banorët e thërrisnin ashtu bukur, shqip, Visiart. Lagjen e Burimit, që për çudi ishte në një majë kodre sepse atje kishte buruar uji, sllavët e kishin quajtur Iz-



vor, ndërsa banorët vendas Burim. Disa banorëve të kësaj lagje u mbeti mbiemri Izvira, por jo Izvori. Izvira u dukej më shqip, më dibrançe. Goldvis ishte fshat e kaluar fshatit, por administrativisht varej nga Visiarti dhe mbeti në juridiksionin e një lagjeje. E çfarë nuk kishte në këtë fshatlagje! Me shtëpitë përballë lindjes së Diellit, fshatarët merrnin dy prodhime. Prodhimin e parë në perime dhe prodhimin e

dytë në grurë e thekër. Në këtë fshat ishin të gjitha varietetet e mollëve, të dardhave, kumbullave, rrushit, arrave, gështenjave, lajthive si dhe pemëve të rralla.

Fshati ndahej nga dy fshatrat e tjerë; Gjurišta dhe Mirasi, nga dy kodra të buta që ngriheshin në të majtë të rrjedhës së lumit të Drinit të Zi. Lugina e Drinit ishte pjesë e lagjes së Visiartit të Poshtëm. Vërshimet e Drinit ishin të fuqishme në dimër, por për çudi sa arrinin në Visiartin e Poshtëm, aty sikur zbuteshin derisa arrinin të bëheshin pjesë e jetës së banorëve. Banorët prej tyre shpesh merrnin humus e drurë për t'i përdorur për nevojat e tyre të përditëshme. Lumi i Drinit u ofronte edhe peshkun e veçantë të troftës që banorët i thonin pikakuq sepse kishte disa pika të kuqe të arta. Përveç pikakuqit, musteqari ishte peshku më i mirë i lumit. Kur rriheshin[2] peshqit, banorët e dinin kohën dhe kujdeseshin që askush të mos i trazonte.

Në sezonin e verës fillonte verimi, larja në lumë, zhytja në hurdhë, ngrohja në rërën e imët dhe gjuetia për peshkatarët. Peshkatarët ishin zanatalinj. Ata kufizonin vaun me gurë dhe ndërtonin vanakun me gjethe shelgu. Në fund të gurëve bënin një grykë të vogël ku grumbullohej peshku dhe aty vendosej një kosh me thupra shelgu. Peshku trazohej me vanakun e shtyrë nga peshkatarët dhe fëmijët e tyre dhe në fund përfundonte

në kosh. Ky ishte gëzim i papërshkruar, si për interesin për ushqim, ashtu edhe për sportin e gjuetisë. Me rërën e imët banorët ndërtonin dhe suvatonin shtëpitë. Në të majtë të Goldvisit ishte përroi me të njëjtin emrin. Në të djathtë ishte përroi i Visiartit. Ky përroi ishte në mes të Visiartit dhe Goldvisit, prandaj që të dy lagjet e kërkonin pronësinë dhe emrin e përroit. Në krye të fshatit Goldvis ishte një kodër rrumbullake e veshur me shkurre e dru lisi që i thonin kodrishtë. Poshtë saj ishte Livadhi i Ristos me kroin në krye të tij. Përroi i Mitros ishte një përrua i vogël, i cili emrin e kishte marrë nga një ushtar sllav që ishte vrarë aty. Banorët nuk ishin lodhur që t'ja ndryshonin emrin se u kujtonte Mitron që e kishin vrarë sepse u preku pyllin e tyre të shenjtë. Edhe Ara e Bllazhos ishte në krye të Livadhit të Ristos. Megjithëse Bllazho e kishte hapur vetë me krahë këtë arë të vogël në mal, përsëri nuk preferonin të ja thonin emrin. Edhe varret sllave te rrënojat e kishës, shekuj më parë, banorët e Goldvisit nuk i shkatruan. Njeriu është rob i Zotit. Faji është i urdhëruesit të luftërave.

Si një kapele mbi kokë të fshatit qëndron Zabeli i Madh dhe Guri i Shalës. Guri i Shalës ishte me të vërtetë një gur mahnitës, tamam si një shalë kali. Thuhej se këtu një kalorësi pushtues i mbeti shala dhe shala ngriu e u bë gur. Guri i Shalës ishte një monument që ruhej nga banorët. Livadhet e gjata me burimin mbi

krye ishin një tjetër mrekulli natyrore e këtij fshati me vise të arta. Si një ombrellë e blertë ishin pemët dhe lisat që banorët u thonin çadrat e Izvirës. Monument natyror i krijuar nga vetë natyra. Më tej Livadhi i Cen Kullës. Nuk dihej nëse Ceni e mori emrin nga kulla që ndërtoi në fund të livadhit apo jo sepse fis Kulla nuk kishte patur në këtë fshat ndër shekuj. Nuk ja prishi as pamjen, as begatinë livadhit Ceni. Kullën e ndërtoi në fund të tij, pranë burimit të ujit dhe e shfrytëzoi livadhin për bar e thekër. Edhe patatet bëheshin sa një kokë njeriu se dheu ishte i lehtë dhe uji i burimit buroi për njerëzit, kafshët e egra, kafshët e buta dhe bimësinë e shumtë. Po të varesh poshtë Livadhit të Cen Kullës do të shkoje në Zallin e Mullkastrës, që derdhej në Drinin e Zi. Po Lajthiza?! Me ujin e lehtë dhe të ftohtë që buronte prej saj shëronte çdo sëmundje të aparatit tretës të njeriut. Banorët i thonin ujë i bekuar. E pra këtë fshat të begatë dhe këtë lumë të bekuar donin t'ua merrnin shqip-tarëve, dibranëve, banorëve të Visiartit. Banorët thonin se donte ta merrte shkjaun, serbi. Disa më të shkolluar thonin se kështu kanë vendosur Fuqitë e Mëdha. Dhimbjen për Drinin nuk mund t'a duronin. Drini ishte ishte fati i tyre. Drini u bë mollë shëri për shtetet dhe Fuqitë e Mëdha sepse vendosën që ai të shërbente si kufi shtetëror. Kjo ishte fatkeqësi e madhe. Që nga ky moment askush nuk kishte më të drejtë të lahej në lumin e tyre, të gjuante peshk, të merrte rërë, të punonte tokën. Nga padronë të tokës së tyre, të lumit të tyre, banorët e Visiartit tani po kthehen në skllevër të padrejtësisë.

-Kjo nuk durohet burra, tha Shaban Cami. Shtëpinë në Gjoricë ma dogji turku se dolëm në luftë kundër Turqisë e Hajredin Pashës, por ne ndërtoam tre kulla të reja, një në Visiartin e sipërm, një në Goldvis dhe një në Miras. Tash duan të na djegin dhe të na zbojmë edhe nga këto troje që të parët tanë na i kanë lanë, por kjo nuk ka për të ndodhur, sepse do t'i mbrojmë me gjakun dhe jetën tonë. Lajmëro burrat e fisit e të krejt fshatit e bëhuni gati për luftë! urdhëroi Shabani.



Aktori i mirënjohur i skenës dhe ekranit Bujar Asqeriu në "Dita e letërsisë dibrane"

Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

"Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor". Nën këtë moto, shkrimtarë të njohur dhe talente të reja u bënë bashkë të enjtën e 10 tetorit 2024 në Bibliotekën e qytetit të Bulqizës, për të prezantuar botimet e tyre dhe për të diskutuar mbi arritjet, por edhe mbi problematikat e letërsisë. Në këtë datë, të Tetorit të Letërsisë, shkrimtarët dibranë, numri i të cilëve kalon mbi 500, bënë apel që të investohet më shumë, që librat të shkojnë në duart e lexuesve.

Iniciatore e këtij takimi qe Bashkia Bulqizë, e cila në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë (LID) dhe Shoqatën atdhetare Bulqiza, organizuan Ditën e Letërsisë Dibrane, në Bibliotekën e qytetit minator. Shkrimtarë të njohur dibranë dhe talente të reja në fushën e letërsisë nga gjimnazi "Arbëria" dhe Këshilli Rinor Bulqizë, u bënë kështu pjesë të këtij takimi mbresëlënës, duke bashkëbiseduar dhe reflektuar mbi fuqinë e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit tonë kulturor.

Është vërtetë inkuarujes shembulli i kryetares së bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtri, e cila përveç zgjidhjes me kompetencë e përkushtim të problematikave të shumta të kësaj bashkie, i kushton vëmendjen e duhur edhe organizimit të takimeve të tilla. Me këtë rast ajo vlerësoi krijimtarinë e shkrimtarëve dibranë që në shekullin e nëtëmbëdhjetë e deri në ditët e sotme, dhe po ashtu premtoi institucionalizimin e datës 10 tetor si "Dita e Letërsisë Dibrane".

KRIJUESIT E TRADITËS LETRARE DIBRANE

Në nismën për intucionalizimin e 10 Tetorit si "Dita e letërsisë dibrane", kryebashkiakja e Bulqizës Festime Mjeshtri gjeti dhe mbështetjen e kryetartit të Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, prof. Dr. Shpëtim Cami – autor i disa librave, si dhe të kryetarit të Shoqatës Bulqiza. Bashkim Lami.



Në përshëndetjet e rastit ata inkurajuan shkrimtarët dhe talentet e reja dibrane në letërsi, që të lexojnë sa më shumë dhe në krijimtarinë e tyre t'iu qasen, jo vetëm përjetimeve e ndjenjave, burimeve arkivore e dokumentare, por sidomos botimeve të atyre personaliteteve që krijuan traditën letrare dibrane, siç janë: poeti dhe gazetari Josif Bageri nga Reka e Dibrës së Madhe, si i pari poet që ka botuar një libër me vjersha; Haki Sharofi, një personalitet poliedrik: Mësues i Popullit, gazetar, poet dhe lëvruer i gjuhës shqipe; Haki Stërmilli - autor i tre romaneve, mbi 30 tregimeve të shkurtëra, pesë pjesëve teatrale, dy ditareve dhe disa dyzina artikuj publicistikë, Prof. Dr. Shaban Sinani, akademik, studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar; Agron Tufa – një ndër shkrimtarët e brezit të sotëm që me veprat e tij renditet me elitën krijuese të kombit; Prof. Dr. fatmir Terziu –shkrimtar, studiues, regjisor, kritik i artit dhe letërsisë. botues i suksesshëm i portalit fjala e lire dhe revistës prestigjioze Albanian Post; Hazis Ndreu – Nderi i kombit, të ci-

• Nderim për krijuesit e traditës letrare dibrane: Josif Bageri poet dhe gazetar; Haki Sharofi, një personalitet poliedrik: Mësues i Popullit, gazetar, poet dhe lëvruer i gjuhës shqipe; Haki Stërmilli - autor i tre romaneve, mbi 30 tregimeve të shkurtëra, pesë pjesëve teatrale, dy ditareve dhe disa dyzina artikuj publicistikë, Prof. Dr. Shaban Sinani, akademik, studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar, etj

lin e kanë quajtur "Ezopi i Dibrës", "Burri i Odës Dibrane", "magu", i cili me prekjën e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo shqiptari - i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian; Prof. dr. Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, që përveçse si aktor, skenarist e regjisor është autor i disa librave monografikë; Prof. dr. Hajri Shehu – filolog, një nga figurat më të spikatura në fushën e gjuhësisë shqiptare, me një kontribut të shquar në leksikografi dhe leksikologji; Xhafer Martini, i cili me krijimtarinë e

tij letrare në prozë e poezi zë vend të veçantë në fondin e artë të letërsisë shqipe; Ahmet Prençi, fuitues i çmimit kombëtar "At Gjergj Fishta" me romanin e tij "Anja" e po aq i kërkuar nga lexuesi me romanin e dytë "Brennga e prokueorit"; Xhelal Ndreu, historian, publicist, romancier, dramaturg, përkthyes; e dhjetra autorë tjerë dibranë.

SHKRIMTARËT E SOTËM DIBRANË PREZANTOJNË BOTIMET E TYRE

Pas fjalëve përshëndetëse të organizatorëve, "Dita e Letërsisë Dibrane" vijoi me prezantimin e botimeve të tyre nga disa autorë pjesëmarrës në këtë takim. Me modesti, përveç monografive (me bashkëautor) kush-tuar filozofit popullor Dine Hoxha, kompozitorit të tangos shqiptare Muharrem Xhediku, gjeneralit legjendë Rrahman Parllaku, Liri Belishovës, ikonës së artit e kulturës Skënder Cala, etj, unë prezantova librin tim të ri "40 vepra letrare të 40 autorëve në 'skaner'" që është i 27-ti në korpusin e botimeve të mia. Për këtë libër, një këndvështrim më të hollësishëm analitik bëri Emmy Krosi, poete, eseiste, analiste dhe një ndër zërat më të spikatur të kritikës së sotme letrare.

"Të lexosh letërsi, sidomos shumë letërsi që shkruhet sot në shumë forma, rryma dhe faqe, të ulesh dhe shkruash përsëri përshtypjet, apo një ese kritike, kumtim apo analizë duhet jo vetëm kohë por edhe kulturë e mjaftueshme. Një ndër autorët, që pothuajse gjendet në 'çdo shtëpi libri', në 'çdo festë libri' është padyshim, miku i të gjithë shkruesve të çdo lloji dhe gjinie, Halil Rama. Pa e mbushur me supërelativa, apo shumë të sheqeror si: 'kritik i madh', 'studiues famoz, përpos titullit 'Mjeshtër i Madh', H.Rama ka meritën e një skanimit ose përimitësimi, apo dekodimi të çdo kodit libror qoftë prozaik, poetik apo dokumentar",-tha ndër të tjera Emmy Krosi.

Më pas Mjeshtri i Madh Fatos Daci, botues i gazetës "Dibra", autor i mbi 70 librave, tërhoqëi vëmendjen e të pranishmëve, sidomos për veprën e tij voluminoze "Enciklopedia e Dibrës", si dhe për veprën e tij studimore "Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës".

Sakip Cami, një tjetër autori i njohur dibranë në fushën e letrave, ndër dhjetra botimet e tij prezantoi librat: "Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit"; "Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër"; "Mos ma prekni lumin tim"; "Fisi ÇAMI i Dibrës" "Drejt NATO-s" dhe "101 poezi".

Dhjetra pjesëmarrësit në këtë takim u impresionuan nga prezan-

(Vijon në faqen 15)



Lamtumirë miku e shoku ynë MENDU OSMAN DEMA!

• *Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri ashtu siç ishte, një studjues i historisë së vendlindjes dhe një edukator i përkushtuar e i dashtur në punë dhe shoqëri*

NGA BASHKIM LAMI

Me daë 4 nëntor 2024 mësuam me hidhërim të thellë nga njoftimi i familjarëve, se ka ndërëruar jetë në moshën 91-vjeçare mësuesi pensionist, Mendu Dema.

Ai ka lindur më 1935 në fshatin Homesh, të Shupenzës, Bashkia Bulqizë. Në vendlindje mbaroi shkollën fillore më 1946 me nota shumë të mira.

Ishte ndër nxënësit e parë në konviktin e Peshkopisë, ku mbaroi shkollën Unike e Pedagogjike në vitin 1953.

Më 1953 emërohet mesues në shkollën 7-vjeçare, Shupenzë.

Më vitin 1960 u emërua mësues në shkollën 7 - vjeçare të fshatit Tuçep.

Gjatë viteve 1962 -1964 kreu shërbimin ushtarak në Korçë, ku u dallua si ushtar shembullor. Në vitin 1964 emërohet mësues në shkollën 7 - vjeçare të Maqellarës.

Më 1967 dërgohet mësues në shkollën 8-vjeçare Zogje, ku punoi për 12 - vite. Pa u shkëputur nga puna si mësues, vazhdoi Institutin Pedagogjik në Shkodër, në fakultetin Histori -Gjeografi, ku u diplomua në vitin 1970 me rezultate mjaft të mira.

Punoi në shkollën 8 -vjeçare Gjoricë e pastaj në Doalan dhe më pas emrohet pak kohe në Zërçan.

Më 1980 emërohet përsëri mësues në shkollën 8 - vjeçare në Shupenzë si dhe në shkollën e mesme të përgjithshme, ku punoi deri në vitin 1992 kur ka dalë në pension. Ishte i martuar në vitin 1962 me znj. Bukurie Dema (Cami) dhe ka katër fëmijë. Kudo ku punoj ai shquhej për përkushtim e profesionalizëm si edukator dhe mësimdhënës.

Mendu Dema ka kryer disa kualifikime si dhe ka qenë për disa kohë anëtar tek "Shoqata e Historianëve të Dibrës". Gjatë kohës si mësues dhe si pensionist është marrë me studime në fushën e Historisë për periudha të ndryshme. Ka përgatitur referate, kumtesa e monografi për në sesione, jubile e përvjetore. Ka shkruar e botuar disa



artikuj në gazetata lokale, duke ndriçuar historinë e zonës. Në vitin 2018 ka botuar në gazetën "Dibra" Poemë historike për Luftën e Drinit, 1844, me titull "HAJREDIN PASHA", që është pritur shumë mirë nga lexuesit dibranë e më gjërë. Ka bërë një studim shumë të detajuar për vendlindjen e tij Homeshin me botimin e librit "HOMESHI NË SHEKUJ" në vitin 2020. Historia e kombit fillon nga vendlindja, kjo devizë e nxiti Mendu Demën të shkruante këtë libër që kontribuon në historinë e Dibrës dhe më gjërë.

Autori e fillon librin e tij studimor që nga koha e neolitit, që nga Uskania dhe penestët dhe e mbaron në ditët e sotme. Shumë ngjarje zhvillohen edhe jashtë fshatit, shumë nga veprimtarët e fshatit të tij me histori, bashkëveprojnë me figura të mëdha historike të Dibrës, Një kujdes

të veçantë autori ka përmendur figurat që kanë lënë gjurmë në Grykën e Vogël dhe ka hartuar dhe shpjeguar toponiminë e fshatit Homesh në këtë studim të tij. Gjatë kohës ka marrë vlerësime për punë e sjellje të mirë. Nga viti 2005 jetonte bashkë me familjen në Tiranë, ku merrte pjesë dhe ndiqte me kujdes e dashuri të gjitha aktivitetet historike e letrare të studjuesve dibranë e më gjërë.

Ai me punën e sjelljen e tij mbetet në kujtesën e njerëzve që e njohën, nga të gjithë fshatrat e më gjerë, që ruajnë respekt për punën e tij educative me brezat e të rinjë e mirësjelljen në shoqëri. Puna dhe vepra e tij mbeten të paharruara në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që e njohën e punuan me këtë njeri që do të na mungojë, por që do ta kujtojmë me shumë dashuri e respekt për punën e kujtimet e bukura që ka lënë.

Miku ynë Mendu Dema ishte krenar për familjen e tij, bashkëshorten Bukurie dhe katër fëmijët, për nipërit e mbesat, që i qëndruan pranë dhe e mbështetën me shumë dashuri në jetën e tij modeste në Homesh dhe në Tiranë. Ai qe një pinjoll i denjë i fisit "Dema", intelektual e dibran i nderuar, mësues i përkushtuar, studjues i talentuar i historisë së vendlindjes, si bleta punëtore shkante fshat në fshat të "Grykës së Vogël" e nëper Dibër duke mbledhur copëza të historisë apo edhe pjesë të folkorit që i ka lanë si pasuri për brezat në libra e shkrime me vlera të mëdha historike. Ai do te kujtohet edhe si familjar shembullor e rrëfimtari i odave. Do të na mungoi, por urtësinë e mençurinë e tij i kemi në mendje e nuk do ta harrojmë. Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, të afërmit, shokët e miqtë e tij.

Kryesia e "Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza" shpreh ngushëllime familjes, fëmijëve të tij e gjithë familjarëve, të afërmve e kolegëve të të ndjerit, Zoti ju dhëntë durim të tejkalonit dhimbjen për njeriun tuaj të dashtur! Lamtumirë miku e shoku ynë i dashtur Mendu Dema! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri ashtu siç ishte i mençur e i dashtur në familje, në punë e shoqëri.

Shpirti i Mendu Demës u prehtë i qetë në parajsë dhe i qoftë dhe i lehtë! Të rrojnë e ta kujtojnë familja, të afërmit dhe të gjithë miqtë e tij!

Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor

(Vijon nga faqja 14)

timi i vëllimeve me poezi të poetëve dibranë Demir Rusi, Barie Çupi, Moza Shehi, Sanie Dëgjoni Ndreka, Miranda Troci, Brunilda Musai, Donika Meta Gjura (të cilët edhe intrpretuan disa poezi nga botimet e tyre), si dhe nga shkrimtarët e studiuesit e trevës së Bulqizës Destan Rama e Ilir Puca.

Më të larmishëm e bëri këtë takim, Bujar Asqeriu, aktor i mirënjohur i skenës dhe ekranit shqiptar, jo vetëm me prezancën e vlerësimin e krijimtarës së autorë dibranë, por sidomos

me interpretimin e dy poezive të poetes nga Bulqiza Barie Çupi.

Shkrimtarët e pranishëm i dhuruan disa nga botimet e tyre Bibliotekës modern të Bulqizës.

TALENTET E REJA - SHKRIMTARËT E SË ARDHMES
SI DËSHMI E KOHËS SË TYRE

"Nxënësit e talentuar në letërsi të Shkollës së Mesme "Arbëria" dhe anëtarët e Këshillit Rinor Bulqizë qenë ndër më aktivët e takimit me logon "Dita e Letërsisë Dibrane". Jo vetëm me prezantimin dhe interpretimin e krijimtarisë së tyre poetike,

por edhe me pyetjet interesante për shkrimtarët e pranishëm. Këta të fundit, s'kish se si të mos vlerësonin interpretimin e krijimtarisë së tyre poetike nga nxënësit shembullorë Elis Bala dhe Artemida Alla.

Ndërsa nxënësit e talentuar në letërsi të këtij gjimnazi: Raela Cani, Suada Suroçaj, Argita Neziri, Edisar Keta, Orgit Zogu, Mario Kika, Marsilda Llorja, Xheniolla Sallaj, Briana Visha dhe Sindi Krosi e shfaqën talentin e tyre nëpërmjet pyetjeve interesante për shkrimtarët e pranishëm, të cilat konsistonin në përzgjedhjen e tematikave, pse shkruajmë, motivet dhe

burimet e frymëzimit, metodat shkrimore në rastin e shkrimit të monografive, titujt e librave të radhës por edhe për burimet e financimit të botimit të librave.

Intersimi i tyre qe i veçantë sidomos për evidentimin dhe vlerësimin e krijimtarisë së tyre. Shkrimtari Fatos Daci si botues i gazetës "Dibra" dhe unë si kryeredaktor i gazetës "Bulqiza", në përgjigje të interesit të tyre premtuam botimin e krijimtarisë letrare të talenteve të reja nga shkollat e mesme e 9-vjeçare të Bulqizës. Kjo për faktin se ata do jenë shkrimtarët e së ardhmes si dëshmi e kohës së tyre.

Gëzuar Vitin e Ri 2025!

16 - JANAR 2025

fotoreportazh

